



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji”, me profil  
“Shëndet Mendor”**

**ofruar nga**

**“Universiteti European i Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Dr. Arjana Muçaj**

**Dr. Manolita Hida**

**Nëntor/ 2025**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**  
**Bachelor në “Psikologji”, me profil “Shëndet Mendor”**

1	IAL aplikues:	Universiteti European i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Psikologji”, me profil “Shëndet Mendor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 496, datë 07.10.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Nr. 07, prot., datë 14.06.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 211, datë 13.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 13, datë 24.01.2020
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohe të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Për vitin akademik: 2022-2023 19 PAE/ 1PAK 2023-2024 18 PAE/ 1 PAK 2024-2025 19 PAE/ 1 PAK
18	Numri i studentëve:	91 studentë në periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2025 (2021-2022= 18; 2022-2023=18; 2023-2024=22; 2024-2025=33)
19	Komente / të tjera:	-




## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në "Psikologji", me profil "Shëndet Mendor" i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve Liberale në Universitetin European të Tiranës bën pjesë në ciklin e parë të studimeve universitare dhe përfundon me dhënien e një diplome përkatëse. Ky program ka një ngarkesë prej 180 kreditesh ECTS dhe zgjat tre vite akademike. Ai u hap për herë të parë gjatë vitit akademik 2010–2011 dhe mori akreditimin fillestar në vitin 2019 (referuar dokumentit me numër 142 në sistem dhe emërtim "Urdhër nr. 251, datë 14.06.2013 Për akreditimin e disa programeve të studimit në BA, MSh, MP").

Programi synon të sigurojë një formim të thelluar teorik, në përputhje me filozofinë e UET-it, duke i mundësuar studentëve të ndërtojnë një karrierë akademike apo profesionale në fushën e psikologjisë. Universiteti ofron një infrastrukturë bashkëkohore, burime shkencore të pasura dhe metodologji moderne për të mbështetur procesin e mësimdhënies. Programi ndërthur komponentët teorikë dhe praktikë, për të nxitur përvetësimin e dijeve moderne dhe zhvillimin e mendimit kritik dhe krijues. Ai mbështetet nga një trupë pedagogjike e kualifikuar dhe përkushtuar në nxitjen e të nxënit me cilësi.

Objektivat e programit janë të përputhura me strategjinë zhvillimore të universitetit dhe mbështeten nga kushte dhe ambiente të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies dhe kërkimit.

Në vitin 2018, në përputhje me ndryshimet ligjore për arsimin e lartë, programi u përshtat me kërkesat e VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, sipas vendimit të Dekanatit Nr. 34/2, datë 15.05.2018 (dokumentacioni gjendet në Hapin: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë)

Në këtë kuadër, programi u pasurua me pesë profile studimi:

- Shëndet Mendor
- Psikologji Edukimi
- Marrëdhënie Publike
- Menaxhim i Organizatave
- Marketing

Më pas, në vitin 2022, pas një procesi riakreditimi, programi pësoi një ristrukturim të mëtejshëm duke u përshtatur sërish me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, përmes vendimit të Senatit Akademik Nr. 5, datë 20.09.2022 (dokumenti i listuar me numër 146 në sistem). Me këtë vendim u hoqën pesë profilet ekzistuese dhe programi vijon të ofrohet vetëm me profilin "Shëndet Mendor", në përputhje me rekomandimet e dhëna nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm dhe përmirësimet e propozuara në kurrikulën mësimore.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi i vlerësimit të jashtëm është realizuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjik të përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Ai është zhvilluar në disa faza të njëpasnjëshme, duke u bazuar në një qasje të strukturuar dhe të standardizuar për të siguruar transparencë, objektivitet dhe koherencë në vlerësim.

Në datat 21 dhe 22 Maj 2025, grupi zhvilloi takime, sipas një agjende të koordinuar nga ekspertja e ASCAL me institucionin, të cilat ishin planifikuar paraprakisht sipas një agjende të detajuar dhe të dakordësuar me institucionin. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga Prof. As. Arjana Muçaj dhe PhD. Manolita Hida. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatoresha teknike e ASCAL, Msc. Rajna Lila.

Fillimisht, u analizua dokumentacioni i dërguar nga institucioni aplikues, përfshirë raportin e vetëvlerësimit, programin e studimit, tabelat RVB, informacionin mbi stafin akademik (PAK/PAE), si dhe aktet ligjore të licencimit, akreditimit dhe riorganizimit. Kjo fazë u shoqërua me shqyrtimin e strukturës së kurrikulës, planifikimit të ngarkesës mësimore sipas krediteve ECTS, burimeve në dispozicion, dhe përputhshmërisë me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.

Më pas është vijuar me vizitën pranë institucioneve të arsimit të lartë dhe takimeve me stafet përkatëse. Gjatë vizitës janë dhënë sugjerimet e nevojshme duke u bazuar në shqyrtimin paraprak të informacionit si dhe gjetje në terrenin konkret.

Në vijim, vlerësimi u përqendrua në analizën e thelluar të të dhënave të stafit, nivelit të përgatitjes dhe përfshirjes së tyre në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, si dhe në raportin ndërmjet stafit të brendshëm dhe atij të jashtëm. Vëmendje e veçantë iu kushtua përputhjes së objektivave të programit me profilin e diplomantit dhe nevojat e tregut të punës.

Procesi përfundoi me hartimin e raportit të vlerësimit të jashtëm, ku janë përfshirë konkluzionet, vlerësimet për secilin standard dhe rekomandimet për përmirësim, të formuluar në mënyrë profesionale dhe të argumentuar. I gjithë vlerësimi është kryer në përputhje me parimet e paanshmërisë, etikës profesionale dhe respektimit të integritetit të institucionit të vlerësuar.

## SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

### I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.13, datë 24.01.2020, janë:

- a. Institucioni, të përshtasë më mirë kurrikulën e programit të studimit me tregun e punës dhe standardet e licencimit nga Urdhëri i Psikologut.
- b. Institucioni, të rekrutojë/angazhojë staf të ri akademik në këtë program studimi, me kualifikim në psikologji dhe profil të njëjtë ose të përafërt me lëndët/modulet që do të mbulojnë.
- c. Institucioni, të përfshijë në emërtimin e programit të studimit në suplementin e diplomës ndarjen sipas profileve.
- d. Institucioni, të shtojë burimet e literaturës në funksion të realizimit të këtij programi studimi me pesë profile, në gjuhën shqipe dhe të huaj.

### II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

#### 1. Institucioni, të përshtasë më mirë kurrikulën e programit të studimit me tregun e punës dhe standardet e licencimit nga Urdhri i Psikologut.

Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” tregon përpjekje për të reflektuar kërkesat e tregut të punës dhe për të përputhur strukturën e tij me standardet e vendosura nga Urdhri i Psikologut. Në planin mësimor janë të përfshira një sërë lëndësh themelore dhe të detyrueshme që përputhen me fushat kryesore të praktikës psikologjike, si psikologjia klinike, zhvillimore, sociale dhe edukative.

Gjithashtu, janë parashikuar komponentë praktikë si **praktika profesionale dhe lëndë me karakter aplikativ**, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e aftësive të transferueshme dhe profesionale të studentëve. Kjo tregon një ndërgjegjësim për rëndësinë e lidhjes së teorisë me praktikën, një kriter kyç për përgatitjen e profesionistëve të ardhshëm të psikologjisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i renditur me numër 14 dhe i emërtuar Kurrikula e programit, janë listuar lëndët sipas tipit të komponentit mësimor ku specifikisht lëndët bazë kanë një peshë në program prej: 17.7%, lëndët karakterizuese përbëjnë 53.3%, lëndët ndërdisiplinore/ integruese përbëjnë 13.3%, lëndët plotësuese përbëjnë 13.8%, detyrimet përmbyllëse 3.8%.

Në vijim paraqitja tabelare e përmbledhur në kredite e lëndëve sipas tabelës 9 të planit mësimor në faqet 30, 31 dhe 32 dhe krahasimi me Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, dhe vendimin nr. 185, datë 25.03.2021. Duke ju referuar kësaj table, përqindja në total e të gjithë krediteve formon 100% e 180 krediteve të pretenduara për ciklin e studimit bachelor në Psikologji “Shëndet mendor”.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Tipi i komponentit lëndor Viti akademik	Lëndë Bazë A	Lëndë karakterizuese B	Lëndë ndërdisiplinore C	Lëndë plotësuese D	Detyrime përmbyllëse	Totali i krediteve
	17.7%	53.3%	13.3%	13.8%	3.8%	100 %
Detyrimi sipas vendimit nr.41, datë 24.2.2018, përditësuar nr. 185, datë 25.3.2021.	15%-20%	50%-55%	12%-15%	10%-15%	3%-5%	100%
A plotësohet detyrimi sipas vendimit nr.41, datë 24.2.2018, përditësuar nr. 185, datë 25.3.2021.	Po	Po	Po	Po	Po	Po

Bazuar në kurrikulën e programit të studimit Ba Psikologji (renditur në rendin e 44 në sistem) dhe në Referimet e kryera nga institucioni përpos përpjekjeve të bëra duke u bazuar në sugjerimet e akreditimit të mëparshëm, ndarja në përqindje e lëndëve korespondon me Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, vendimin nr. 185, datë 25.03.2021, si dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit nr. 13, datë 24.01.2020, për "Akreditimin periodik të studimit të ciklit të parë, Bachelor në Psikologji "Shëndet Mendor", (referuar në RVB me numër Ref. 50, por aktualisht në sistem gjendet me numër reference 144).

**Ngarkesa në auditor dhe format e mësimdhënies** janë të strukturuar mirë: 628 orë leksione, 496 orë seminare, 36.6 orë laborator, 481.2 orë për detyra dhe praktikë, dhe 120 orë praktikë profesionale. Kjo tregon përmbushje të kërkesave për larmi metodash didaktike dhe përfshirje të praktikës profesionale në formimin e studentit.

(Referuar në dokumentacionin i cili gjendet në Hapin: Vizita dy ditore në IAL dhe dokumentacioni shtesë).

**Në bazë të dokumentacionit rekomandimi përmbushet plotësishtë.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

**2. Institucioni, të rekrutojë/angazhojë staf të ri akademik në këtë program studimi, me kualifikim në psikologji dhe profil të njëjtë ose të përafërt me lëndët/modulet që do të mbulojnë.**

Me referencën nr.2 paraqiten të dhënat mbi personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse. Departamenti ka në përbërje të tij personel akademik efektiv në masën prej 95% dhe personel akademik me kontratë në masën prej 5% për vitin akademik 2024-2025.

Mbështetja në burimet e brendshme të institucionit ka ardhur duke u rritur pasi në stafin e pedagogëve ka rikthyer edhe staf të mëparshëm brenda profilit të studimit (referuar të dhënave tabelare për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse renditur me numër 0.2), duke treguar në këtë formë edhe qëndrueshmëri në menaxhimin e burimeve njerëzore e më tej në shërbimin ndaj studentëve.

**Raporti PAE/PAK –** Në të gjithë vitet akademike 2020–2025, raporti PAE/PAK është ruajtur ose ka tejkaluar standardin minimal të kërkuar. Në disa raste, raporti ka qenë 31/0 apo 22/1, duke treguar përfshirje minimale të PAK dhe mbështetje të fortë në staf me kohë të plotë. **Në bazë të dokumentacionit rekomandimi përmbushet plotësishtë.**

**3. Institucioni të përfshijë në emërtimin e programit të studimit në suplementin e diplomës ndarjen sipas profileve.**

Në dokumentacionin e dorëzuar nga ana e Institucionit në rendin 15.1 është paraqitur modeli i diplomës dhe suplementi ku është vendosur ndarja në profilin “Diplomë Bachelor në Psikologji me profil Shëndet Mendor”, si profil i vetëm që ofrohet aktualisht pranë këtij institucioni. **Në bazë të dokumentacionit rekomandimi përmbushet plotësishtë.**

**4. Institucioni, të shtojë burimet e literaturës në funksion të realizimit të këtij program studimi me pesë profile, në gjuhën shqipe dhe të huaj.**

Menaxhimi dhe funksionimi i bibliotekës kryhet mbi bazën e rregullores të listuar në rendin e 104 si dhe në numrin 105 gjendet shembull procedure për blerje literature ndërsa formulari për pasurimin e literaturës në bibliotekë renditet me numrin 106.

Aktualisht institucioni ofron bibliotekën fizike me një shumësi titujsh në gjuhën shqipe dhe jo vetëm dhe me autorë të ndryshëm të cilët kanë lënë gjurmë dhe kanë formuar e më tej zhvilluar mendimin psikologjik. Përpos bibliotekës fizike ndodhet edhe biblioteka online në të cilën është abonuar institucionin, i “Elgar Online” nëpërmjet të cilës mund të aksesojnë studentët dhe stafi.

Nga ana tjetër për ti ofruar studentëve literaturë bashkëkohore institucioni ka përshatur brenda strukturave të veta rregullore në të cilën botimet duhet të jenë brenda 5 viteve të fundit dhe ti ofrohet studentëve pra në gjuhën shqipe (Çdo lëndë ka të përcaktuar literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në VKM nr. 41/2018. Literatuta bazë është e përditësuar, e përzgjedhur nga botime të njohura si Oxford University

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Press, Cambridge University Press, Sage etj., çka tregon për orientim drejt burimeve cilësore dhe bashkëkohore.). Në bazë të dokumentacionit rekomandimi përmbushet plotësishtë.

*Universiteti European i Tiranës, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 10.11.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr.31 / 24 Prot, datë 10.11.2025. Universiteti European i Tiranës, njofton në ASCAL më datë 18.11.2025, me anë të shkresës me Nr.271/9 Prot, datë 14.11.2025 "Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.*

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Psikologji, profil “Shëndet Mendor”.**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteret</b>  <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Në përputhje me vizionin e Planit Strategjik të UET për vitet 2021–2025 (renditur në rendin nr.6, pika për referim Vizioni-fq.2), të gjitha veprimtaritë e institucionit janë konceptuar për të sjellë përfitime për shoqërinë në tërësi, në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë. Po ashtu, sipas Strategjisë së Kërkimit Shkencor të UET (2021–2025) (renditur në rendin nr.8, pika 1.1, fq.1), konkretisht në pikën 1.1, synimi kryesor i universitetit është të shndërrohet në një Qendër Ekselence, e cila prodhon rezultate kërkimore me cilësi të lartë dhe me ndikim të dukshëm në nivel kombëtar dhe rajonal.</p> <p>Të gjitha programet e studimit të ofruara në UET – përfshirë edhe programin Bachelor në Psikologji – janë të përputhura plotësisht me prioritetet dhe objektivat strategjike kombëtare. Këto programe synojnë të përqafojnë dhe të mbështesin këto objektiva, duke ndjekur vizionin e UET, sipas të cilit arsimit i lartë dhe universitetet luajnë një rol thelbësor dhe të pazëvendësueshëm në krijimin e dijes.</p> <p>Në këtë kontekst, universitetet pritet të kalojnë nga institucione të përqendruara kryesisht në mësimdhënie, në qendra elitare të kërkimit shkencor, të cilat prodhojnë dije që u përgjigjet nevojave të tregut të punës në Shqipëri dhe më gjerë. Strategjia e Kërkimit Shkencor e UET (2021–2025) është plotësisht në linjë me objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit (2021–2026) (renditur në rendin nr. 10.), ku theksohen prioritetet si: rritja e cilësisë në arsimin e lartë, përmirësimi i mësimdhënies dhe kërkimit, lidhja me tregun e punës, integriteti dhe transparenca, përqendrimi tek studenti, ndërkombëtarizimi dhe dixhitalizimi i arsimit.</p> <p>Kësisoj, UET synon të jetë një aktor kyç në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik të vendit përmes arsimit cilësor dhe kërkimit të orientuar drejt nevojave reale të shoqërisë dhe tregut (<i>dokumenti i renditur në referencën 4- Plani</i>)</p>



	<p><b>strategjik për zhvillimin e programit, Vizioni, pika 9, fq.3-me numër rendor 11).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji në Universitetin European të Tiranës është konceptuar në përputhje me misionin, objektivat dhe fushën e veprimtarisë së institucionit (statuti i UET, neni 6 pika 6.1 dhe 6.2, fq.3-renditur në rendin nr. 5). Qëllimi i tij është përgatitja e specialistëve në fushën e shëndetit mendor (psikologë), duke vendosur theksin te njohuritë dhe aftësitë profesionale që lidhen me këtë fushë, si dhe duke iu përgjigjur kërkesave aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës në Shqipëri dhe më gjerë (statuti i UET, neni 6 renditur në rendin nr. 5).</p> <p>Ky program është ndërtuar në përputhje me dokumentet bazë të institucionit, si Statuti i UET (statuti i UET, neni 6, Qëllimi dhe Objektivat: vizioni, misioni dhe objektivat strategjike - renditur në rendin nr. 5), Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Manuali për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, 1.1. Vision/Mission of the European University of Tirana-renditur në rendin nr.60), dhe Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë; Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë 2023-2028, pika 1.2. Vizioni dhe Misioni i Institucionit, pika 2.1. Objektivat Strategjike- renditur në rendin nr. 62 duke reflektuar misionin e universitetit për të ofruar një arsim cilësor të mbështetur në kërkim shkencor me vlerë, në funksion të zhvillimit të dijes dhe shoqërisë shqiptare. Programi synon të kombinojë mësimdhënien me kreativitetin, përdorimin e arritjeve më të avancuara shkencore, dhe bashkëpunimin me tregun e punës dhe partnerët ndërkombëtarë (Statuti i UET, Neni 6, Qëllimi dhe Objektivat: Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike (Ref. Nr.2) renditur në rendin nr.5).</p> <p>Nëpërmjet strukturës së këtij programi, UET realizon objektivat e përcaktuara në Planin e tij Strategjik, veçanërisht angazhimin për t'u ofruar studentëve një eksperiencë akademike cilësore, të mbështetur në dije, metoda dhe teknika moderne të mësimdhënies (Plani Strategjik 2021-2025, Proritetet, I "Edukimi", I.1. Angazhimet në procesin mësimor, pika 2, (Ref. Nr.3.3) renditur me numrin 9). Në këtë kuadër, UET synon që të gjitha programet e tij të ndërtohen sipas modeleve më të mira të universiteteve perëndimore, në përputhje me Kushtet e Kartës së Bolonjës, dhe të jenë të harmonizuara me zhvillimet social-ekonomike dhe dinamikat e tregut të punës.</p> <p><b>Evidencat:</b></p>




	<p><i>Statuti i UET, Neni 6, Qëllimi dhe Objektivat: Vizioni, Misioni dhe Objektivat Strategjike (Ref. Nr.2) renditur në rendin nr.5; Plani Strategjik 2021-2025, Proritetet, I "Edukimi", I.1. Angazhimet në procesin mësimor, pika 2, (Ref. Nr.3.3) renditur me numrin 9).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" me profil, "Shëndet Mendor", i ofruar nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve në UET, është konceptuar për të zhvilluar dhe përçarur njohuritë përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, me qëllim përditësimin dhe zgjerimin e bazës teorike dhe praktike të kurrikulës. Kjo është në përputhje të plotë me objektivat strategjike të institucionit në fushat e arsimit dhe kërkimit (Plani Strategjik 2015-2020, (Ref. Nr.3-mungon); Plani Strategjik 2021-2025 (Ref. Nr.3.3)-renditur me numrin 9; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Ref. Nr.3.1)-renditur me numër 7; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 (Ref. Nr.3.2) renditur me numër 8).</p> <p>Rregullorja e programit përkufizon qartë objektivat e tij, të cilat përfshijnë përgatitjen e studentëve me njohuri dhe koncepte të thelluara në fushën e psikologjisë, zhvillimin e aftësive profesionale dhe mundësitë për avancim në karrierë (Rregullore e programit të studimit BA Psikologji (shqip), (Ref. Nr.7- renditur me numrin12).</p> <p>Programi pasqyron vizionin institucional për të rritur cilësinë e mësimdhënies përmes metodave novatore dhe për të ofruar njohuri bashkëkohore që kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të zhvillimit social dhe ekonomik në vend. Në pikën 7 të Planit Strategjik të UET për periudhat 2015–2020 dhe 2021–2025, theksohet rëndësia që i kushtohet kapitalit njerëzor, duke u mbështetur në idenë se universitetet nuk duhet të prodhojnë thjesht studentë të informuar, por mendje krijuese dhe të afta për zhvillim. Prioritet u jepet kreativitetit, aftësive teknike dhe profesionale, si dhe formimit të individëve që dinë të përshtaten me realitetin, të nxisin iniciativën dhe të krijojnë shërbime ose biznese; Plani Strategjik 2021-2025, Vizioni, pika 8, (Ref. Nr.3.3) renditur me numrin 9).</p> <p>Plani strategjik i zhvillimit të këtij program (Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Ba Psikologji (Ref. Nr.4) renditur me numër 11) është në përputhje të plotë me prioritetet dhe objektivat (Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimit Ba Psikologji, pika II- Objektivat e Programit të Studimit (Ref. Nr.4) renditur me numër 11) e përgjithshme strategjike të UET (Plani Strategjik për</p>

	<p>Zhvillimin e Programit të Studimit Ba Psikologji, pika III-Prioritetet që orientojnë Programin e Studimit, (Ref. Nr.4) renditur me numër 11; Plani Strategjik 2021-2025, (Ref. Nr.3.3) renditur me numër 9), si dhe me Strategjitë për Kërkimin Shkencor (Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Ref. Nr.3.1), renditur me numër 7; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021 -2025 (Ref. Nr.3.2) renditur me numër 8) të miratuara për periudhat 2017–2020 dhe 2021–2025. Sipas pikës 1.2 të Strategjisë së Kërkimit Shkencor, kërkimi në UET mbështet drejtpërdrejt përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, përmes ngritjes së ekspertizës së stafit akademik, transferimit të njohurive shkencore moderne tek studentët, si dhe përfshirjes aktive të tyre në veprimtari kërkimore. Fusha e shëndetit mendor, në të cilën fokusohet ky program, përbën një nga drejtimet kryesore të kërkimit në universitet (Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020, Vizioni pika 1.2, (Ref.Nr. 3.1) renditur në numrin 7).</p> <p><b>Evidencat :</b> <b>Plani Strategjik 2021-2025 (Ref. Nr.3.3)-renditur me numrin 9; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2017-2020 (Ref. Nr.3.1)-renditur me numër 7; Strategjia e Kërkimit Shkencor UET 2021-2025 (Ref. Nr.3.2) renditur me numër 8).</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Statuti i institucionit (Statuti i UET, neni 15, pika 15.2. (Ref. Nr.2), renditur me numër 5), Rregullorja e programit (Rregullore e programit të studimit Ba Psikologji (shqip), 3, renditur me numër 12. Programi i Studimit, (Ref. Nr.7) renditur me numër 24.) dhe Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit përcaktojnë qartë drejtimet akademike prioritare, duke e pozicionuar njësinë bazë si një qendër moderne studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive. Qëllimi është që ajo të jetë pjesë e një sistemi të integruar global, ku studentët e diplomuar nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve Liberale të jenë të aftë të gjejnë vendin e tyre në treg dhe të kontribuojnë me dije dhe profesionalizëm në fushën e Psikologjisë.</p> <p><b>Evidencat:</b> <b>Statuti i UET; Rregullore e programit të studimit Ba Psikologji (shqip)</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit janë plotësisht në përputhje me profilin akademik dhe kërkimor të njësisë bazë përgjegjëse për programin, në përputhje me klasifikimin/kodifikimin 72MS0313S</p>

<p>përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>(Programet e studimit_Licencimi_akreditimi_statusi) dhe me udhëzimet e direktivat kombëtare. Kjo përputhje reflektohet në të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve (sipas të dhënave për numrin e programeve të ofruara nga njësia përgjegjëse, Ref. nr. 26, të renditura me numër 52).</p> <p><b>Evidenca:</b> <i>Të dhënat për numrin e programeve të ofruara nga njësia përgjegjëse.</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi “Bachelor në Psikologji” me profil “Shëndet Mendor” është në përputhje të plotë me misionin, fushën akademike dhe strategjitë institucionale të UET. Ai zhvillohet nga njësia përkatëse akademike dhe mbështetet në burimet dhe kapacitetet e saj. Programi kontribuon në zhvillimin e dijes, ruajtjen e vlerave kombëtare dhe përgatitjen e profesionistëve të aftë për tregun e punës dhe nevojave socio-ekonomike të vendit.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.2</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Përgjegjësitë dhe detyrat për hartimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e programit “Bachelor në Psikologji” janë të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Pësha kryesore i takon Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, si njësi bazë përgjegjëse për zbatimin e programit dhe përfshirjen e stafit të kualifikuar. Roli i drejtuesit të njësisë, koordinatorit dhe stafit akademik është i qartë dhe i ndarë sipas akteve përkatëse. Institucioni nxit bashkëpunimin e brendshëm përmes ndarjes së përgjegjësisë, komunikimit dhe analizës së vazhdueshme të punës. Procesi mësimor monitorohet nga instancat drejtuese të UET, duke përfshirë Rektorin, Dekanin, Përgjegjësin e Departamentit dhe Zyrën e Kurrikulës. Çdo vit zhvillohet një analizë vjetore e punës së njësisë bazë (<i>Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave formuese Ba Psikologji (Ref. nr. 38) renditur me numër 93</i>).</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për të realizuar objektivat formues dhe mësimorë të programit, institucioni ka vendosur politika bashkëpunimi me institucione brenda dhe jashtë vendit, që përfshijnë ndërtimin e kapaciteteve, shkëmbimin e stafit, zhvillimin e programeve dhe forcimin e lidhjes teori–praktikë. Në këtë kuadër, janë nënshkruar marrëveshje me Urdhrin e Psikologut të Shqipërisë dhe institucione të tjera si Instituti Adler, Prana Zone, Mental Health Albania, Aksion Plus (mbështetur nga Lista e subjekteve dhe intitucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktika profesionale (<i>ref. nr. 34) renditur në numrin 87, 88, 89, 90</i>) etj. Këto bashkëpunime krijojnë mundësi për praktika profesionale, zhvillim kompetencash dhe përfshirje në projekte të përbashkëta për studentët dhe pedagogët.</p> <p>Marrëdhëniet e bashkëpunimit realizohen kryesisht në nivel fakulteti dhe departamenti, të cilët mbajnë rolin kryesor në hartimin dhe zbatimin e projekteve. Koordinimi bëhet nga Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, në bashkëpunim me Rektoratin dhe Dekanatin. Përmes programit Erasmus+, është mundësuar shkëmbimi i përvojave ndërkombëtare për studentët dhe pedagogët.</p> <p><i>Evidenca 34: Memorandum bashkëpunimi klinika Prana Zone nr. Prot. 2, datë 17.06.2019;</i>  <i>Evidenca 34: Memorandum bashkëpunimi nr. Prot. 80, date 10.05.2021 Mental Health Albania Shpk; Memrorandum bashkëpunimi UET-Aksion Plus, nr. Prot. 172 prot, datë 25.03.2024;</i>  <i>Evidenca 34: Memorandum bashkëpunimi, UET &amp; Qendra Multidisiplinore e Shërbimeve Psikologjike dhe Ligjore Family, prot 164, date 18.06.2019</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Në fokus mbeten praktikat profesionale dhe lidhja me tregun e punës, duke kontribuar në rritjen e mundësive për punësim dhe përshtatjen e programit me kërkesat reale të tregut (Lista e subjekteve dhe institucioneve bashkëpunuese për programin e studimit dhe praktikat profesionale (<i>Ref. Nr. 34</i>), <i>renditur me numër 87, 88, 89, 90</i>; Rregullore e progamit mësimore, Bsc në “Psikologji”, Pika 7 renditur me numër 24; Sylabus i praktikës profesionale Ba Psikologji (<i>dokumenti me numër 19, renditur me numrin 51, fq. 199-202</i>); <i>Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale (Ref 32.3) renditur me numër 85</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia</p>	<p>Në kuadër të analizës së ecurisë së programit, Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve ka hartuar analiza</p>

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.

periodike (*Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave ref.38, numër rendor 93*) dhe raporte vjetore, ku vlerësohen arritjet dhe përcaktohen objektivat për të ardhmen. Në këto raporte pasqyrohen edhe përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit, si të formalizuara ashtu edhe joformale. Studentët e nivelit Bachelor kanë përfituar nga këto bashkëpunime përmes praktikave profesionale dhe mundësive punësimi pranë qendrave si Aksion+, Albanian Center of Autism dhe ABA “We Love Children”, duke forcuar aftësitë e tyre praktike në fushën e psikologjisë së zhvillimit dhe ndërhyrjeve terapeutike për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Evidenca 38: Analiza e departamentit mbi arritjen e objektivave; Memorandume bashkëpunimi shih në kriteret më sipër.**

**Konkluzione**

*Programi “Bachelor në Psikologji” fokusohet në praktikat profesionale dhe lidhjen me tregun e punës, duke ofruar mundësi punësimi dhe përmirësim të aftësive për studentët. Departamenti i Psikologjisë monitoron dhe analizon rregullisht ecurinë e programit, ndërsa bashkëpunimet me institucione të ndryshme, si Aksion+ dhe Urdhri i Psikologut të Shqipërisë, sigurojnë praktika dhe zhvillim profesional. Koordinimi dhe mbikëqyrja bëhen nga strukturat akademike dhe administrative të institucionit, duke përfshirë edhe shkëmbime ndërkombëtare përmes Erasmus+.*

<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR**

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri, duke iu referuar ligjit “Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 33, pika 3, fq.13 (Ref. Nr. 53) ,udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", e ndryshuar (Ref. nr. 53.1) <b>renditur në numrin 129; Plani Strategjik për zhvillimin e Programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11)</b>, dokumenteve rregullore të Universitetit Europian të Tiranës (statutit dhe rregulloreve përkatëse), si dhe praktikës aktuale akademike (<b>Rregullore e UET, Neni 16, fq.5 (Ref. Nr.5) renditur me numrin 12; Rregullore e programit mësimorë, Ba Psikologji; Plani Strategjik për zhvillimin e Programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 4) renditur me numrin 11; Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji (Ref. Nr. 7) renditur nr.24)</b>. Ai është gjithashtu në përputhje me vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, që përcakton elementet përbërëse të programeve të studimit.</p> <p>Struktura e programit BA në Psikologji përfshin komponentë të ndryshëm mësimorë si mësimi në auditor, studimi i pavarur, përgatitja për provime, përgatitja e temës së diplomës dhe praktika profesionale. Kurrikula është ndarë në pesë kategori kryesore lëndësh dhe aktivitete:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kategoria A – Lëndë bazë: përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (32 ECTS)</li> <li>2. Kategoria B – Lëndë karakterizuese: formim në disiplinën kryesore të studimit (96 ECTS)</li> <li>3. Kategoria C – Lëndë ndërdisiplinore/integruese: lëndë me zgjedhje dhe fusha të lidhura (24 ECTS)</li> <li>4. Kategoria D – Lëndë plotësuese: gjuhë të huaja, teknologji informacioni dhe praktika profesionale (21 ECTS)</li> <li>5. Kategoria E – Detyrime përfundimtare: punimi i diplomës dhe projekt profesional (7 ECTS) (<b>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji (Ref. Nr.7) renditur nr.24)</b>.</li> </ol> <p>Në total, programi përmban 180 ECTS, ku çdo kredit përfaqëson 25 orë pune të studentit, të ndarë mes mësimit në auditor dhe punës individuale.</p>
---	--

	<p><b>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji; Ligji i Arsimit të Lartë nr. 80/2015, datë 22.07.2015, Neni 33, pika 3, fq.13; Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit", e ndryshuar; Evidenca 4: Plani Strategjik për zhvillimin e Programit Ba Psikologji; Statuti dhe dokumentet rregullatore të Universitetit European të Tiranës: Rregullore e UET;</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimeve BA në Psikologji përfaqëson një përgjigje të mirëstrukturuar ndaj nevojave për avancim në nivelet e kualifikimit akademik. Ai i pozicionon në mënyrë të favorshme studentët e diplomuar për të vijuar studimet në ciklin e dytë dhe, potencialisht, në ciklin e tretë, duke u ofruar gjithashtu një profil konkurrues në tregun e punës.</p> <p>Përmbajtja e programit fokusohet në formimin themelor të studentit, duke përfshirë njohuritë mbi origjinën dhe kufijtë e disiplinës së psikologjisë, konceptet kryesore, si dhe analizën krahasuese të modeleve empirike të ndërtuara nga kjo fushë shkencore (<b>Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës dhe të përdorimit të literaturës, pika A.III.4.1.1(Ref.Nr.39) renditur me numrin 94</b>).</p> <p>Ky program synon të pajisë studentin me (Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 3.3 (Ref. Nr.7) renditur nr.24):</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njohuri dhe koncepte themelore të psikologjisë;</li> <li>2. Aftësi për orientim drejt profesionit dhe përfitimit të një licence profesionale;</li> <li>3. Formim qytetar të gjerë dhe ndërdisiplinor;</li> <li>4. Kompetenca bazë për përfshirje në veprimtari kërkimore;</li> <li>5. Aftësi praktike dhe aplikative të përgjithshme;</li> <li>6. Mbështetje për zhvillimin dhe promovimin personal;</li> <li>7. Diplomë që, ndonëse nuk përfshin komponentë kërkimore origjinale, dëshmon përvetësimin dhe kuptimin e punës së studuesve në fushën përkatëse.</li> </ol> <p><b>Evidenca 7: (Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 3.3 (Ref. Nr. 7) renditur nr.24)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese</p>	<p>Programi i studimit përcakton qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale, si dhe për detyrimet përmblyëse të ciklit të parë të studimeve. Numri i krediteve të çdo lënde mësimore apo veprimtarie formuese është i ndërtuar</p>

<p>duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>mbi bazën e ngarkesës në orë mësimore në auditor dhe të punës së pavarur që studenti duhet të kryejë për të përmbushur kërkesat e programit përkatës.</p> <p>Për përfundimin me sukses të programit, studenti duhet të përfitojë të paktën 180 ECTS. Çdo njësi krediti përfaqëson 25 orë pune studentore, të cilat përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. orë mësimore në auditor për transmetimin e dijes (përmes leksioneve, seminareve, ushtrimeve praktike, projekteve apo detyrave),</li> <li>2. si dhe orë për përgatitje individuale dhe punë të pavarur jashtë auditorit.</li> </ol> <p>Ky përkufizim i ngarkesës synon të sigurojë një balancë efektive ndërmjet të mësuarit të udhëzuar dhe zhvillimit të aftësive të vetëmenaxhimit dhe punës së pavarur nga ana e studentit. (<i>Plani Strategjik për zhvillimin e Programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11</i>)</p> <p><b><i>Evidenca 4. Strategjia e zhvillimit BA Psikologji (1).pdf</i></b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Lëndët e përfshira në programin e studimit janë të kredituara në mënyrë të diferencuar, në varësi të përmbajtjes, kompleksitetit dhe ngarkesës mësimore që ato kërkojnë. Shumica e lëndëve mbartin një ngarkesë prej 6 ECTS, por disa lëndë me karakter themelor dhe formues kanë ngarkesë më të lartë, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi-8 ECTS</li> <li>• Psikologji e personalitetit – 8 ECTS</li> <li>• Hyrje në këshillim – 8 ECTS</li> <li>• Psikologji konjitive – 8 ECTS</li> <li>• Hyrje në psikologji klinike – 8 ECTS</li> <li>• Anglisht – 4 ECTS</li> <li>• Bazat e informatikës – 4 ECTS</li> <li>• Punimi i diplomës / Provimi Përgjithshëm</li> </ul> <p>Përfundimtar – 7 ECTS</p> <p>Gjithashtu, programi parashikon praktikën profesionale si një komponent të detyrueshëm formues, e cila mbart 6 ECTS dhe është e përfshirë në mënyrë të detajuar në sylabusin përkatës. Kjo praktikë organizohet dhe monitorohet nga pedagogu përgjegjës i lëndës, në bashkëpunim të ngushtë me Drejtuesin e Departamentit.</p> <p>Praktika profesionale është një kusht i domosdoshëm për përfundimin e programit. Studentët që nuk e përmbushin këtë detyrim nuk kanë të drejtë të paraqiten për mbrojtjen e</p>




	<p>diplomës apo për të dhënë provimin përfundimtar. <i>(Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 3.3 (Ref. Nr.7) renditur nr.24).</i></p> <p><i>Një element i cili do t'i vinte në ndihmë realizimit të praktikës profesionale për studentët, edhe pse në kushtet në të cilat ata nuk janë aplikues direkt të njohurive në rastet të cilat përfitojnë nga shërbimet psikologjike do të ishte dhe përfshirja e lëndës së etikës në ushtrimin e profesionit të psikologut. Kjo lind si domosdoshmëri edhe për shkak të ndryshimit të modalitetit të realizimit nga dije të përfuara në auditore në dije të cilat përftohen në terrenin konkret të realizimit të profesionit. Ndaj lënda e etikës e pajis studentin si profesionist i së ardhmes me një mjet mbrojtës për të ushtruar korrektësisht profesionin, e ndihmon të kuptojë kufijtë e kompetencës personale, i vjen në ndihmë kërkuesve të shërbimit e kështu me rradhë dhe do të forconte lidhjen e studentin me profesionin dhe entet rregullatore të tij.</i></p> <p><b><i>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji</i></b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve në këtë program realizohet në përputhje të plotë me Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Universiteti Europian i Tiranës (UET) është një institucion jo publik i arsimit të lartë, që operon në përputhje me kuadrin ligjor përkatës dhe nuk gëzon status të veçantë (siç është, për shembull, ai i institucionit publik apo i atij me status të veçantë akademik).</p> <p>Programi është i organizuar me kohë të plotë, në përputhje me format standarde të ofrimit të studimeve universitare.</p> <p>Financimi i institucionit dhe i programeve të tij bazohet kryesisht në të ardhurat që vijnë nga tarifat e studimit, si dhe nga angazhimi në projekte kërkimore dhe zhvillimore, në të cilat Departamenti është përfshirë në mënyrë aktive.</p> <p><b><i>Evidenca 4. Strategjia e zhvillimit BA Psikologji (1).pdf</i></b>  <b><i>Evidenca 6. Dokumenti F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit.pdf</i></b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë</p>	<p>N/A</p>

<p>studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi BA në “Psikologji”, me profil “Shëndet Mendor” është një program i ciklit të parë të studimeve, i ndërtuar mbi një ngarkesë totale prej 180 kreditesh (ECTS), në përputhje me Niveli 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Ky program identifikohet me kodin e kodifikimit 72MS0313S.</p> <p>Sa i përket kodifikimit të përgjithshëm institucional të programeve të studimit, ai është në pritje të përditësimit sipas akteve nënligjore që pritet të miratohen nga Ministria përgjegjëse, në vijim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 310, datë 11.05.2022.</p> <p>Çdo lëndë që përfshihet në programin e studimit është e pajisur me kod individual identifikues, i cili është i specifikuar dhe i dokumentuar në sylabusin përkatës të secilës lëndë.</p> <p><i>Evidenca 31.1. VKM Nr.310, datë 11.05.2022_Kodifikimi programeve.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji nuk është një program i përbashkët me ndonjë institucion tjetër të arsimit të lartë. Megjithatë, Universiteti Europian i Tiranës (UET) shpreh gatishmërinë për të zhvilluar programe të përbashkëta studimi, në bashkëpunim me një ose më shumë institucione të arsimit të lartë, publike apo jopublike, kombëtare apo ndërkombëtare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe standardet e cilësisë në arsimin e lartë.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit BA në “Psikologji” me profil “Shëndet Mendor” në Universitetin Europian të Tiranës është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore për arsimin e lartë në Shqipëri, duke respektuar ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe dokumentet rregullatore të universitetit. Ai përmban një strukturë të qartë dhe të balancuar me 180 ECTS, të ndara në kategori të ndryshme lëndësh dhe aktiviteteve mësimore, duke siguruar një ngarkesë të përshtatshme mes mësimin në auditor dhe punës së pavarur të studentit. Programi plotëson standardet akademike dhe profesionale, duke përfshirë praktikën profesionale si një komponent të detyrueshëm por që nevojitet të komplementarizohet edhe me lëndën e etikës dhe deontologjisë së psikologut. Organizimi dhe financimi i programit janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet</i></p>

	<i>e arsimit të lartë në Shqipëri, duke garantuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e tij me nevojat e sistemit arsimor dhe kërkesat e tregut.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																					
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve Liberale ka nën varsinë e tij 3 njësi kryesore:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Arteve të Aplikuara</li> <li>2. Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve</li> <li>3. Departamenti i Shkencave Humane dhe Komunikimit</li> </ol> <p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Psikologji”, me profil “Shëndet Mendor”, përmbushin të gjitha detyrimet ligjore dhe nënligjore lidhur me organizimin dhe strukturën akademike. Fakulteti është themeluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 636, datë 20.09.2006, dhe është riorganizuar me Urdhër të Ministrit Nr. 526, datë 04.09.2018. Universiteti European i Tiranës (UET) është një institucion i akredituar, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017, dhe pas riorganizimit, me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2015 Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 80, Ref. nr.53.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th> <th colspan="2">Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale (viti akademik 2024-2025)</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof.Dr</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Prof.Asoc</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr/PhD</td> <td>7</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc</td> <td>21</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>41</b></td> <td><b>10</b></td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjithashtu, UET ka përmbushur standardet institucionale dhe është akredituar edhe nga Quality Assurance Agency (QAA) e Mbretërisë së Bashkuar, duke marrë akreditimin e fundit</p>		Kualifikimi i stafit	Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale (viti akademik 2024-2025)		PAE	PAK	Prof.Dr	7	2	Prof.Asoc	6	1	Dr/PhD	7	2	Msc	21	5	<b>Gjithsej</b>	<b>41</b>	<b>10</b>
Kualifikimi i stafit	Fakultetit të Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale (viti akademik 2024-2025)																					
	PAE	PAK																				
Prof.Dr	7	2																				
Prof.Asoc	6	1																				
Dr/PhD	7	2																				
Msc	21	5																				
<b>Gjithsej</b>	<b>41</b>	<b>10</b>																				

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

anglez (VBA Nr. 82 datë 22.09. 2023 - Akreditimi Periodik Institucional ASCAL- QAA renditur me numrin 135).

Si njësi kryesore ku ofrohet programi i studimit, Departamenti përmbush të gjitha kërkesat për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik. Departamenti zotëron kapacitetet e nevojshme të stafit akademik për realizimin e programit të studimit në mënyrë cilësore. Personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe përfshirjen aktive në procesin mësimor (Të dhëna tabelore për personelin akademik në njësinë kryesore dhe njësinë përgjegjëse (Aneks Tabela 1,2) renditur me numrin 2).

Në këtë departament janë të angazhuar:

**Të dhëna për Departamentin e Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve:**

Tituj/ grada	2022 –2023		2023 – 2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	3	-	3	1
Prof. Asoc.	3	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	4	2	3	-	3	-
Dr. Proc	1	-	3	1	3	1
Msc.	8	3	3	-	3	-
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>5</b>	<b>14</b>	<b>1</b>	<b>15</b>	<b>2</b>

Evidenca 2: Tabelat RVB.pdf (tabela 1.1; 1.2, 2.1;2.3);

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 636, datë 20.09.2006; Urdhri i Ministrit Nr. 526, datë 04.09.2018; Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 12, datë 07.04.2017; Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr. 46, datë 05.07.2015; Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Quality Assurance Agency (QAA).

**Kriteri 2. Njësi kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në**

Në këtë program studimi për ciklin Bsc në “Psikologji”, studentët zhvillojnë leksione në auditor me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës së psikologjisë dhe vizitonin institucione të ndryshme psikologjike, nën drejtimin e pedagogut të lëndës. Ndërkohë, në vitin aktual akademik, praktikat

<p>legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>profesionale janë zhvendosur dhe zhvillohen drejtpërdrejt në institucione përkatëse (Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale (Ref.Nr. 32.1),renditur nr. 85).</p> <p><b>Evidenca 32.1 Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale.</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Dr. E. S. ka qënë përgjegjëse e grupit mësimor për programin Bachelor në Psikologji në momentin e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm. Detyrat e saj janë të përcaktuara në aktet rregullatore të UET (Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit (Ref. nr. 36) renditur me nr. 91; Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit (Ref. Nr. 6) renditur me nr. 19) dhe në aneksin bashkëlidhur vendimit të emërimit. Ajo ka qënë e angazhuar në dokumentimin periodik të të gjithë informacionit që lidhet me programin e studimit dhe mban përgjegjësi për kontrollin e cilësisë së mësimdhënies, përfshirë planprogramet (syllabuset), tekstet, metodologjinë, si dhe vlerësimin e tezave dhe eseve.</p> <p><b>Evidenca 36: Vendimi i emërimit të koordinatorit të programit;</b> <b>Evidenca 6: Dokumenti F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e departamentit.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në përfundim, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve Liberale, nëpërmjet Departamentit të Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve, dëshmon përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare të cilësisë në arsimin e lartë. Programi i studimit Bachelor në "Psikologji" me profil "Shëndet Mendor" mbështetet në një strukturë akademike të konsoliduar dhe staf të kualifikuar që garanton cilësi të lartë në mësimdhënie dhe formim profesional. Akreditimet institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë atë të QAA-së britanike, konfirmojnë standardet e zhvillimit akademik dhe institucional të universitetit. Departamenti përmbush në mënyrë të qëndrueshme kriteret për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, duke siguruar mbulimin e plotë të lëndëve në përputhje me fushën e studimit. Këto elemente reflektojnë angazhimin e institucionit për cilësi, transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm të ofertës akademike në fushën e psikologjisë.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Fakulteti dhe Departamenti përgjegjës për programin Bachelor në Psikologji disponojnë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm mbi organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, të aksesueshëm në sistemin elektronik “Dokumenta UET”. Informacioni është i qasshëm për stafin akademik e administrativ, ndërsa studentët e marrin përmes platformës LMS (Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS (Ref. Nr. 46.1) renditur me nr. 108) dhe faqes zyrtare të universitetit ( <a href="https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2024/01/BA-Psikologji.pdf">https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2024/01/BA-Psikologji.pdf</a> ).
	<i>Evidenca 46.1: Urdhër mbi zbatimin e platformës LMS.</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban planin mësimor, i cili përfshin informacion të detajuar mbi ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore dhe ndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij. Struktura dhe plani mësimor janë pjesë përbërëse e rregullores së programit dhe publikohen në fillim të çdo viti akademik. Programi është i ndërtuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe përfshin komponentët formues, profesionalë dhe praktikë, të detajuar në kurrikulën përkatëse dhe syllabuset përkatës.
	<i>Evidenca 14 : Kurrikula e programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 14) renditur me nr. 44)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Rregullorja e programit të studimit përfshin dispozita të detajuara mbi pranimin e studentëve, të cilat janë të përcaktuara në pikën 2 të saj ( <i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 2, fq.2 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i> ), në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullat institucionale. Gjithashtu, në pikën 9 janë përfshirë kriteret dhe procedurat ( <i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 2 dhe 9, fq.2 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i> ) për transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve ( <i>Dokumenti D.II Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studenteve (Ref. Nr. 28) renditur me nr. 55; Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e praniit të studenteve, pika D.I 2, fq.57 - 58 (Ref. Nr.271) renditur me nr. 53</i> ), duke garantuar një proces të rregullt dhe të dokumentuar të ekuivalentimit akademik.
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban	Çdo lëndë e programit të studimit shoqërohet me një silabus të detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga

<p>informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>përgjegjësi i grupit mësimor dhe drejtuesit e departamentit përkatës. Silabusët përgatiten në përputhje me kuadrin ligjor dhe dokumentet udhëzuese të Universitetit Europian të Tiranës, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatet e të nxënit (Learning Outcomes), ku përcaktohen njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët duhet të arrijnë;</li> <li>• Struktura e seminarëve dhe praktikave, ku specifikohen objektivat, temat, aktivitetet praktike dhe detyrat për studentët;</li> <li>• Detyrat e kursit dhe metodat e vlerësimit, përfshirë ndarjen e peshës së secilit komponent në notën përfundimtare;</li> <li>• Komponentët formues, të cilët përfshijnë aktivitete kërkimore, projekte të lidhura me tregun e punës dhe përvojat praktike të studentëve.</li> </ul> <p>Informacionet për secilën lëndë paraqiten në silabusin e lëndës të miratuar paraprakisht (<i>Syllabuset e Lëndëve (Ref. Nr. 19) renditur me nr. 51; Format i sillabusit të lëndës (Ref. Nr.19.1) renditur me numër 48) dhe në përputhje me udhëzimet përkatëse dhe dokumentin AIII të Broshurës së Dokumenteve të UET (Dokumenti A.III. Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika A III 8, (Ref. Nr. 39)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi Bachelor në Psikologji përditësohet çdo vit për të reflektuar zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës, bazuar në burime shkencore, sugjerime të stafit dhe studentëve. Silabusët miratohen nga përgjegjësi i grupit mësimor dhe ruhen në format dixhital dhe fizik. Programi përshtatet rregullisht për të integruar kompetenca të reja, qasje bashkëkohore dhe rekomandime studentore. Ndryshimet nuk tejkalojnë kufirin ligjor prej 20%, siç përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë (Ligji 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në JAL në RSH", Neni 35, pika 1;</p> <p><i>Kurrikula e programit Ba Psikologji, renditur me nr. 44; Rregullorja e UET, Neni 16, pika 3 (Ref. Nr. 5) renditur nr. 12; Dokumenti E.VIII Mbi funksionimin e Zyrës së Kurrikulave, pika E V ITI 1 ; EV 111 3, fq.88, (Ref. Nr.1 3) renditur me nr. 43; Vendim departamenti ).</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi "Bachelor në Psikologji" në UET është i strukturuar sipas kuadrit ligjor dhe dokumentacioni i tij është i aksesueshëm për stafin dhe studentët. Plani mësimor përfshin ndarjen semestrale të lëndëve, ngarkesën mësimore</i></p>

	<i>dhe komponentët formues, profesionalë dhe praktikë. Rregullorja e programit përcakton qartë kriteret për pranimin dhe transferimin e studentëve, si dhe procedurat për njohjen e krediteve. Çdo lëndë shoqërohet me silabus të miratuar që përfshin rezultatet e të nxënit, strukturën e seminareve, detyrat dhe metodat e vlerësimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi Bachelor në Psikologji i UET synon të përgatisë studentët për tregun e punës përmes zhvillimit të njohurive teorike dhe aftësive praktike, duke nxitur kreativitetin dhe iniciativën individuale. Kurrikula ndërthur komponentë teorikë dhe praktikë, duke garantuar përvetësimin e kompetencave ndërdisiplinore si mendimi kritik dhe komunikimi efektiv (Plani Strategjik UET 2021 -2025, pika 1.1 fq.3, (Ref.Nr. 3.3) renditur me nr. 9; Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit Ba Psikologji. fq. 1 ; fq .2.a.2; (Ref. Nr. 4) renditur nr.11). Procesi mësimor është interaktiv dhe i strukturuar në mënyrë të tillë që ngarkesa të jetë e shpërndarë në mënyrë të balancuar gjatë gjithë ciklit të studimit. Praktika profesionale zhvillohet në semestrin e dytë dhe përfshin leksione me profesionistë dhe vizita në institucione psiko-sociale, ndërsa frekuentimi i saj është i detyrueshëm 100% (Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 3.3., pika 3.3.2 fq.2 (Ref. Nr.7) renditur nr.24).  <i>Evidenca 3.3: Plani Strategjik UET 2021 -2025; Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji; Evidenca 4: Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit Ba Psikologji</i>
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore	Modulet e kurrikulës së programit janë të strukturuar në mënyrë që studentët të kenë një ngarkesë të balancuar gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke mundësuar arritjen e objektivave formues dhe rezultateve të pritshme. Procesi

<p>mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>mësimor zhvillohet në mënyrë interaktive, duke kombinuar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve.</p> <p><i>Evidenca 39: Dokumenti A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës;</i>  <i>Evidenca 4: Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit Ba Psikologji</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura e programit të studimit në UET është ndërtuar sipas strategjisë institucionale, duke synuar përshtatjen me kërkesat e tregut të punës. Programi siguron balancë midis njohurive teorike dhe aplikimeve praktike (<i>Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji, pika IV, fq. 4 (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11</i>), me module të strukturuar sipas standardeve ndërkombëtare. Ai mbështetet në literaturë bashkëkohore dhe eksperiencë të vendeve të zhvilluara, çka lehtëson njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës nga institucione të tjera. Kjo qasje ndihmon studentët në zhvillimin profesional dhe akademik në përputhje me praktikën më të mira evropiane (<i>Dokumentit A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika 12.2. (ref. Nr.39), renditur me nr. 94</i>).</p> <p><i>Evidenca 4: Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji; Evidenca 39: Dokumenti A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimeve në Psikologji pranë UET është ndërtuar mbi një strukturë teoriko-praktike që mbështet zhvillimin e kompetencave profesionale dhe përshtatjen me tregun e punës. Modulet janë të shpërndara në mënyrë të balancuar përgjatë ciklit të studimeve, duke lehtësuar përvetësimin e objektivave formues dhe njohurive ndërdisiplinore. Mësimi zhvillohet në mënyrë interaktive, ndërsa praktika profesionale është e detyrueshme dhe zhvillohet me përfshirjen e ekspertëve të fushës. Programi bazohet në literaturë bashkëkohore ndërkombëtare dhe synon përgatitjen e studentëve për tregun vendas dhe atë ndërkombëtar. Për ushtrimin e profesionit të psikologut, kërkohet përfundimi i ciklit të dytë të studimeve dhe pajisja me licencë.</p> <p><i>Evidenca 4: Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji; Evidenca 39: Dokumenti A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen</p>	<p>Modeli i programit të lëndës (Dokumentit A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika 12.2. (ref. Nr.39), renditur me nr. 9) që shërben për hartimin e syllabus-eve</p>




<p>në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>përmban të gjithë elementët e përcaktuar në legjislacionin përkatës. Syllabuset e të gjitha lëndëve të programit janë ndërtuar në përputhje me këtë model dhe përfshijnë: informacionin bazë për lëndën, rezultatet e të nxënit, konceptet kryesore, temat e detajuara, format e vlerësimit të dijes, rregullat e ndjekjes dhe kontrollit të vazhdueshëm, si dhe literaturën përkatëse. Në fund përfshihen vërejtjet përfundimtare të pedagogut.</p> <p>Literatura në çdo syllabus ndahet në literaturë bazë (e detyrueshme) dhe literaturë ndihmëse, e cila shërben për thellimin e njohurive dhe për zhvillimin e aftësive të pavarura të kërkimit (<i>Kurrikula e programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 14) renditur me nr. 44; Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji, pika b.2, fq.3 (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11; Analiza e departamentit mbi arritjet e objektivave formues fq. 4, (Ref. Nr. 38), renditur me nr. 93; Syllabuset e Lëndëve (Ref. Nr. 19) renditur me nr. 51; Formati i relacionit per monitorimin e silabuseve (Ref. Nr. 37), renditur me nr. 92</i>). Literatura bazë duhet të jetë e botuar nga një ndër shtëpitë botuese prestigjioze ndërkombëtare, si: Oxford University Press, Cambridge University Press, McGraw-Hill, si dhe shtëpitë botuese Sage, Routledge, Pearson dhe Elsevier. Ajo nuk duhet të jetë më e vjetër se pesë (5) vite nga momenti i përfshirjes në syllabus. (<i>Dokumenti A.III: Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës, pika A.III.12, fq. 19 (ref. Nr.39), renditur me nr. 94</i>).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Programi i studimit në Psikologji synon t'u ofrojë studentëve një arsimim cilësor, nëpërmjet një qasjeje moderne dhe të balancuar midis teorisë dhe praktikës. Mësimdhënia mbështetet në kreativitet, interaktivitet, përdorimin e metodave bashkëkohore dhe në përvetësimin e arritjeve më të mira shkencore, si dhe në ndërtimin e partneriteteve me tregun e punës dhe institucionet ndërkombëtare.</p> <p>Studentët fitojnë njohuri në lidhje me aplikimin e metodave inovatore në procesin mësimor, të cilat nxisin mendimin kritik, lidhshirësinë dhe shkathhtësitë ndërpersonale. Programi është ndërtuar për të përgatitur studentët me kompetenca të nivelit bazë dhe të mesëm në psikologji, të domosdoshme për vazhdimin e ciklit të dytë të studimeve dhe për të qenë konkurrues në tregun e punës. (<i>Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji, p.V, fq. 2 (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11</i>).</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në Psikologji është i konceptuar në përputhje të plotë me kërkesat e tregut të punës, duke i pajisur studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike që u ofrojnë atyre një avantazh konkurrues në ndërtimin e një karriere të suksesshme, kryesisht në fushën e psikologjisë, por edhe në fusha të tjera që kërkojnë formim të gjerë akademik dhe psikologjik.</p> <p>Megjithëse profesioni i psikologut është një profesion i rregulluar me ligj, dhe për ushtrimin e tij kërkohet kualifikim i mëtejshëm dhe licencim përkatës, formimi i marrë gjatë këtij cikli studimesh (<i>Statuti UET, Neni 6, fq. 3 (Ref. Nr. 2); renditur me nr. 5; Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese, (Ref. Nr. 38), renditur me nr. 93</i>) u mundëson studentëve të angazhohen në role të tjera pune që kërkojnë aftësi të zhvilluara në të kuptuarin e sjelljes njerëzore, komunikimin ndërpersonal dhe menaxhimin e situatave sociale e emocionale.</p> <p><b>Evidenca 2: Statuti UET;</b> <b>Evidenca 38: Analiza e departamentit përgjegjës mbi arritjen e objektivave formuese.</b></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi Bachelor në Psikologji pranë Universitetit European të Tiranës ofron një formim të balancuar teorik dhe praktik, duke i pajisur studentët me kompetenca bazë dhe ndërdisiplinore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut të punës. Procesi mësimor zhvillohet në mënyrë interaktive dhe përfshin praktika profesionale të detyrueshme, të mbështetura nga ekspertë të fushës. Kurrikula mbështetet në literaturë bashkëkohore dhe kombinon teorinë me aplikime reale për të nxitur mendimin kritik, komunikimin efektiv dhe zhvillimin profesional të studentëve. Për të ushtruar profesionin e psikologut, kërkohet përfundimi i ciklit të dytë të studimeve dhe pajisja me licencë përkatëse.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht <b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.5</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Departamenti është i angazhuar për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës. Në bazë të Statutit të UET, çdo program studimi konsultohet dy herë në vit me Bordin e Tregut të Punës (<i>Bordi i Tregut të punës (Ref. Nr.12.1) renditur me nr. 37; Studimi (periodik) për tregun e punës, (Ref. Nr. 17) renditur me nr. 47</i>), që përfshin përfaqësues nga bizneset dhe profesionet përkatëse. Kjo qasje siguron përshtatje efektive dhe në kohë me zhvillimet dhe kërkesat e tregut (<i>Statuti UET, Neni 16, 18.4, 19.2.4, 19.6.2, fq. 7.9 (Ref. Nr. 2); renditur me nr. 5; Plani Strategjik UET 2021 - 2025 f. 5 (Ref. Nr. 3.3), renditur me nr. 9; Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit. F.V.2.3. (Ref. nr. 6), renditur me nr. 19</i>).</p> <p><b>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të punës;</b>  <b>Evidenca 2: Statuti UET;</b>  <b>Evidenca 3.3: Plani Strategjik UET 2021 - 2025;</b>  <b>Evidenca 6: Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Departamentit. F.V.2.3</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Universiteti European i Tiranës (UET) synon përfshirjen aktive të studentëve në vendimmarrje dhe zhvillimin akademik përmes përfaqësimit të tyre në strukturat institucionale si Senati Akademik, Këshilli i Etikës dhe KSBC (<i>Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC; Të dhëna për anëtarët e KSBC (Ref Nr. 30.4; 30), renditur me nr. 50, 64</i>). Studentët më të dalluar angazhohen në kërkimin shkencor, botime, konferenca dhe aktivitete akademike. UET bashkëpunon ngushtë me Alumni, duke i përfshirë në Bordin e Tregut të Punës dhe strukturat drejtuese, për të reflektuar mbi zhvillimet e tregut dhe përmirësimet në programet studimore (Plani Strategjik UET 2021 – 2025, pjesa “<i>Prioritetet në marrëdhëniet me studentët dhe jetën studentore</i>”, pika 1 (<i>Ref. Nr. 3;3. 3</i>), renditur me nr. 9). Zyra e Këshillimit të Karrierës mban lidhje të rregullta me të diplomuarit për të ndjekur punësimin apo vijimin e studimeve. Këto politika janë pjesë e prioriteteve të Planit Strategjik 2021–2025 dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme për të përmirësuar ofertën akademike dhe jetën studentore.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në</p>	<p>Programi Bachelor në Psikologji i UET është ndërtuar sipas standardeve bashkëkohore dhe reflekton nevojat e tregut të punës (<i>Studimi (periodik) për tregun e punës, (Ref. Nr. 17) renditur me nr. 4</i>) si dhe rekomandimet nga akreditimet e mëparshme. Kurrikula ofron një balancë të mirë mes përmbajtjes teorike dhe praktike, duke përgatitur studentët</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>(Plani Strategjik për zhvillimin e programit të studimit BA Psikologji, (Ref. Nr. 4) renditur me nr. 11; Plani Strategjik UET 2021 - 2025, renditur me nr. 9) për punësim në sektorë të ndryshëm si shëndetësia, arsimit, shërbimet sociale dhe drejtësia, por edhe për vazhdimin e studimeve në ciklet më të larta. UET është i angazhuar në bashkëpunime me universitete dhe institute kërkimore në vendet e BE-së, OECD dhe rajonin e Ballkanit (Plani Strategjik UET 2021 – 2025, pika IV.a, fq.7 (Ref. Nr. 3.3), renditur me nr. 9), duke nxitur shkëmbimin akademik dhe mobilitetin. Po ashtu, universiteti mbështet fuqimisht rrjetëzimin dhe bashkëpunimin ndërstudentor përmes projekteve të përbashkëta dhe zhvillimit të kompetencave akademike dhe profesionale.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>Departamenti është i përkushtuar ndaj përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit, në përputhje me zhvillimet e tregut të punës dhe rekomandimet nga akreditimet e mëparshme, përmes bashkëpunimit të rregullt me Bordin e Tregut të Punës. UET synon përfshirjen aktive të studentëve në vendimmarrje dhe zhvillimin akademik, si dhe angazhimin e tyre në kërkime shkencore dhe aktivitete akademike. Bashkëpunimi me rrjetin ALUMNI dhe institucionet ndërkombëtare forcon reflektimin mbi përmbajtjen kurrikulare dhe nxit mobilitetin dhe zhvillimin profesional të studentëve. Të gjitha këto janë pjesë integrale e Planit Strategjik 2021–2025 dhe zbatohen në mënyrë të qëndrueshme për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe jetën studentore.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

**Standardi III.1**  
**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Rregullorja e Universitetit Europian të Tiranës përcakton qartë format e mësimdhënies dhe të nxënies, të cilat përfshijnë leksione, seminare, detyra kursi dhe praktika profesionale, të detajuara në planin mësimor të çdo lënde (<i>Rregullore e UET, Neni 17, pika 1, fq.5 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>). Procesi mësimor kombinohet me forma vlerësimi të vazhdueshme, duke i mundësuar studentëve të përmirësojnë njohuritë e tyre në kohë reale dhe të avancojnë individualisht. Gjithashtu realizohet dhe lidhja midis praktikës dhe tregut të punës (<i>Rregullore e UET, Kreu Y, Neni 45, pika 5 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>). Në bashkëpunim me institucione publike e jopublike, zhvillohen leksione të hapura dhe vizita studimore (<i>Bordi i Tregut të punës (Ref. Nr.12.1) renditur me nr. 37; Studimi (periodik) për tregun e punës, (Ref. Nr. 17) renditur me nr. 47</i>) për të njohur nga afër realitetin profesional dhe shërbimet psikosociale. Këto aktivitete i shërbejnë përgatitjes praktike të studentëve dhe lehtësimit të integritit të tyre në tregun e punës.</p> <p><b>Evidenca 5: Rregullore e UET;</b>  <b>Evidenca 12.1: Bordi i Tregut të punës;</b>  <b>Evidenca 17: Studimi (periodik) për tregun e punës</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies dhe të mësimnxënies janë të përcaktuara në syllabus-in (<i>VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara", i ndryshuar (Ref. Nr. 53.1), renditur me nr. 129; Dokumenti A.III Mbi parimet e ndërtimit të programit të lëndës (Ref. Nr.39), renditur me nr. 94; Syllabusët e Lëndëve të ofruara për programin Ba Psikologji (Ref.Nr.19) renditur me nr. 51</i>) e çdo lënde, duke u ndërtuar sipas nevojave të saj dhe të studentëve. Syllabusi përfshin elementë si metodat pedagogjike, literaturën bazë dhe atë shtesë. Në procesin mësimor përdoren mjete ndihmëse si tabela, kompjuteri dhe projektori, ndërsa metodat interaktive si diskutimet, puna në grupe dhe analizat e rasteve synojnë të nxisin mendimin kritik dhe të zhvillojnë aftësitë analitike të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies.</p>	<p>Programi Bachelor në Psikologji pranë Universitetit Europian të Tiranës zbatohet përmes një metodologjie të plotë dhe bashkëkohore (<i>Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit (Ref. Nr. 43) renditur me nr. 100</i>) të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të strukturuar në leksione, seminare, ese/detyra kursi dhe praktika profesionale (<i>Raporti në lidhje me mobilitetin e stafit dhe studentëve (Ref. nr. 43.1)</i>). Procesi mësimor përfshin përdorimin e mjeteve didaktike moderne</p>

	<p>dhe metodave interaktive si analiza rastesh, punë në grupe, diskutime dhe trajnime që nxisin mendimin kritik e analitik. Syllabuset e lëndëve pasqyrojnë qartë format dhe metodat mësimore, literaturën e kërkuar, si dhe mënyrat e vlerësimit të studentëve përmes një procesi të vazhdueshëm formues. Lidhja me tregun e punës forcohet përmes leksioneve me ekspertë të fushës dhe vizitave studimore në institucione të ndryshme, si Aksion Plus, Mental Health Albania, Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor, etj.</p> <p>Stafi akademik angazhohet në zhvillimin profesional të vazhdueshëm përmes trajnimeve periodike si “Staff Development Day”, “Back to Work” (Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin (Ref. Nr.33), renditur me nr. 86) dhe metodologjive mbi “Learning Outcomes” dhe “Student-Centered Learning”. Gjithashtu, UET ofron mundësi për shkëmbime akademike me universitete partnere europiane, duke siguruar që përvoja mësimore të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë dhe zhvillimit profesional (Të dhënat për shkëmbimin e stafit (ref. Nr.43) renditur me nr. 100).</p> <p><b>Evidenca 33: Të dhëna për trajnimet profesionale për stafin;</b>  <b>Evidenca 34: Të dhëna mbi kërkimin shkencor të stafit të programit; Memorandume bashkëpunimi</b></p>
<p><b>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</b>  Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Stafi akademik i përzgjedhur për mësimdhënie rekrutohet (Dokument G. Rregullore për burimet njerëzore (ref. Nr. 11), renditur e nr. 34) mbi bazën e kriterëve të qarta dhe transparente, si: kualifikimet akademike, përvoja në arsimin e lartë, përfshirja në kërkim shkencor dhe përvoja profesionale. UET zhvillon vlerësime të rregullta për performancën e stafit akademik, duke nxitur rritjen e vazhdueshme të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Trajnimi dhe zhvillimi profesional i stafit akademik mbështetet në mënyrë të strukturuar përmes aktiviteteve si “Staff Development Day”, trajnimi vjetor “Back to Work”, si dhe trajnimet për “Learning Outcomes”, “Methodological Training” dhe “Student-Centered Learning”. Gjithashtu, stafi ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit me universitete partnere europiane, duke përfutuar nga përvoja ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim.</p> <p>Këto masa përbëjnë një garanci për përmbushjen e standardeve akademike (Format dosje staf akademik (Ref.</p>




	<p><i>Nr. 44), renditur me nr. 102, 103)</i> dhe përgatitjen cilësore të studentëve për integrim në tregun profesional dhe akademik.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Universiteti Europian i Tiranës e konsideron përfshirjen aktive të studentëve dhe marrjen e mendimit të tyre një element thelbësor në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të performancës së stafit akademik. Në këtë kuadër, zhvillohet çdo muaj një mbledhje e hapur me studentët, me fokus adresimin e çështjeve akademike dhe administrative përmes sugjerimeve të tyre (<i>Mbledhje e hapur me studentët (Ref. 12.7), renditur me nr. 42).</i></p> <p>Mësimdhënia moderne bazohet në një planifikim të strukturuar të përmbajtjes, metodologjisë dhe teknikave të përdorura për të arritur objektivat mësimore. Stafi akademik përmirëson vazhdimisht format dhe metodat e mësimdhënies, në bashkëpunim dhe përmes feedback-ut të studentëve (<i>Rregullore e UET, Kreu X, Neni 42, pika f, fq.1 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12).</i></p> <p>Në përputhje me përmbajtjen e syllabus-it përkatës, personeli akademik aplikon metoda interaktive dhe diskutimi, duke e bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe duke rritur ndërveprimin në klasë. Orët interaktive ndërthurin shpjegimin teorik me qasje praktike dhe synojnë angazhimin e drejtpërdrejtë të studentëve (<i>Syllabuset e Lëndëve (Ref. Nr. 19) renditur me nr. 51).</i></p> <p><i>Ndër instrumentet kryesore që sigurojnë këtë ndërveprim janë: diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e mendimit kritik dhe pjesëmarrjen aktive të studentëve në procesin mësimor.</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse</p>	<p>Në Universitetin Europian të Tiranës (UET) funksionon Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) (Dokumenti F.VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (ref. Nr. 8), renditur nr. 25), një strukturë institucionale me status të përhershëm dhe autonom. Anëtarët e këtij komisioni propozohen nga Rektori dhe miratohen nga Senati i Universitetit (<i>Urdhër Administrativ mbi përbërjen e KSBC (Ref Nr. 30.4) renditur me nr. 50, Të dhëna për anëtarët e KSBC (Ref. Nr. 30) renditur me nr. 64).</i></p> <p>KSBC ka për detyrë të vlerësojë periodikisht performancën e aktiviteteve akademike dhe kërkimore, si dhe të rekomandojë masa për përmirësimin e cilësisë, duke u mbështetur në</p>




<p>mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>standardet e hapësirës europiane të arsimit të lartë dhe në legjislacionin përkatës (<i>Statuti UET, Neni 16, pika I, fq. 7 (Ref. Nr. 2); renditur me nr.5).</i></p> <p>Në kuadër të funksioneve të saj, kjo njësi bashkëpunon ngushtësisht me strukturat kryesore të universitetit dhe zbaton aktivitete të planifikuara në funksion të monitorimit dhe rritjes së cilësisë së procesit mësimor.</p> <p>Qëllimet kryesore të KSBC-së përfshijnë (<i>Plani i veprimit të KSBC (ref. Nr. 30.1) renditur me nr. 59):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rritjen e vazhdueshme të cilësisë institucionale përmes politikave, strategjive dhe procedurave bashkëkohore, duke angazhuar të gjitha nivelet drejtuese dhe organizative;</li> <li>• Zbatimin e qëndrueshëm të filozofisë akademike të UET-it, në përputhje me orientimet strategjike të institucionit;</li> <li>• Përmirësimin e vazhdueshëm të përgatitjes së studentëve, përmes ofrimit të dijeve, metodave dhe teknikave moderne të mësimdhënies, si dhe nxitjes së pjesëmarrjes aktive të tyre në procesin vendimmarrës (<i>Dokument i F.VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë (ref. Nr. 8), renditur nr. 25; Statuti UET, Neni 16, pika I, fq. 7 (Ref. Nr. 2); renditur me nr.5).</i></li> </ul>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Universiteti European i Tiranës zbaton një metodologji bashkëkohore mësimdhënieje, të mbështetur në syllabus-in e çdo lënde, me fokus në ndërthurjen e teorisë me praktikën dhe në përdorimin e metodave interaktive. Procesi mësimor shoqërohet me vlerësim të vazhdueshëm dhe lidhet ngushtë me tregun e punës përmes leksioneve me ekspertë dhe vizitave studimore. Stafit akademik përfshihet në zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe vlerësohet rregullisht mbi bazën e kriterëve të qarta. Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) garanton përmirësimin e cilësisë akademike dhe kërkimore, në përputhje me standardet europiane.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

**Standardi III.2**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Studentët informohen që në fillim për mënyrat dhe kriteret e vlerësimit, të përcaktuara qartë në syllabus-in e lëndës ( <i>Rregullore e UET, Neni 23, fq.7 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i> ). Vlerësimi bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe përfshin: provimin e ndërmjetëm, detyrat e kursit, diskutimet në seminare dhe provimin përfundimtar (po aty). Institucioni siguron transparencë në vlerësim dhe ofron mbështetje për studentët përmes zyrave të këshillimit akademik dhe të karrierës (po aty).
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Studentët informohen mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit nga titullari i lëndës (Syllabuset e Lëndëve (Ref. Nr. 19) renditur me nr. 51) përmes syllabus-it dhe platformave si LMS (Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS (Ref. nr. 46.1) renditur me nr.108) dhe TEAMS (Video-trajnime mbi sistemin TEAMS/LMS (Ref. Nr. 46.4) renditur me nr. 111). Vlerësimi (Rregullore e UET, Kreu V, Neni 23/24 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12; Format i sillabusit të lëndës (Ref. Nr.19.1) renditur me numër 48) kryhet me pikë (0–100) dhe rezultati përkthehet në nota nga 4 në 10 dhe shkronja nga F në A, ku nota kaluese është nga 5 (E) e lart. Forma të ndryshme vlerësimi përdoren (me shkrim dhe/ose me gojë) dhe njoftohen me postë elektronike nga titullari i lëndës.  <i>Evidenca 19: Syllabuset e Lëndëve;</i> <i>Evidenca 46.1: (Urdhër Mbi zbatimin e platformës LMS dhe TEAMS;</i> <i>Evidenca 46.4: Rregullore e UET;</i> <i>Evidenca 19.1: Format i sillabusit të lëndës</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Vlerësimi i studentit realizohet në mënyrë të vazhdueshme, përmes komponentëve të ndryshëm të përcaktuar në syllabus dhe njoftimeve zyrtare. Ai synon nxitjen e të nxënit gjatë gjithë vitit, vlerësim objektiv dhe matjen e përvetësimit të njohurive ( <i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i> )). Metodot përfshijnë teste me gojë e me shkrim, detyra praktike, si dhe pjesëmarrjen aktive në mësim. Rezultatet përkthehen në nota numerike dhe me shkronja sipas sistemit standard. Pedagogët zgjedhin format më të përshtatshme sipas natyrës së lëndës.
<b>Kriteri 4.</b> Njësia bazë/Personeli akademik	Institucioni i arsimit të lartë demonstroi një angazhim të vazhdueshëm për përfshirjen aktive të studentëve në

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>përmirësimin e procesit mësimor. Për këtë qëllim, organizohen në mënyrë periodike focus grupe dhe mbledhje të hapura mujore me studentët e programeve të ndryshme, ku adresohen shqetësimet dhe sugjerimet e tyre lidhur me cilësinë e mësimdhënies. Përmes platformës LMS, studentët japin vlerësime të drejtpërdrejta mbi përvojën e tyre akademike. Bazuar në këto vlerësime, autoritetet përkatëse ndërmarrin masa konkrete, që mund të përfshijnë ndryshime në planprogram, përmbajtje kurrikulare apo staf akademik, kur është e nevojshme.</p> <p>Gjithashtu, procesi mësimor është konceptuar në mënyrë që të nxisë angazhimin aktiv të studentëve përmes metodave ndërvepruese si diskutime, raste studimore, punë në grupe dhe prezantime. Këto forma kontribuojnë në rritjen e cilësisë së të nxëniet dhe shërbejnë si tregues për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p><i>Mbledhje e hapur e departamentit (Ref.nr. 12.7) renditur me (nr 42).</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxëniet, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Një komponent kyç në sigurimin e cilësisë së brendshme në institucion është zhvillimi profesional i stafit akademik. Universiteti Europian i Tiranës (UET) ofron një program të strukturuar trajnimi për pedagogët, i cili përshtatet me nivelin e gradës shkencore të secilit anëtar të stafit. Aktivitetet përfshijnë organizimin periodik të “Staff Development Day”, me fokus në zhvillimin e kapaciteteve në fushat e mësimdhënies, kërkimit shkencor, projekteve dhe metodologjisë akademike.</p> <p>Në fillim të çdo viti akademik, organizohet seminari dyditor “Back to Work”, ndërsa janë zhvilluar gjithashtu trajnime specifike, si ai mbi “Learning Outcomes”, që synojnë të ndihmojnë stafin në hartimin e silabuseve dhe përgatitjen e provimeve në përputhje me standardet bashkëkohore të arsimit të lartë. Përveç trajnimeve të brendshme, stafi akademik përfiton edhe nga mundësitë e shkëmbimeve ndërkombëtare me universitete partnere perëndimore, duke ndihmuar në shkëmbimin e përvojave dhe përvetësimin e praktikave më të mira në mësimdhënie, të nxënë dhe transmetim të dijes. <i>(Të dhënat për trajnimet profesionale për stafin (Ref. Nr. 33) renditur me numër 86; Të dhënat për shkëmbimin e stafit (ref. Nr. 43) renditur me nr. 100)</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni siguron një proces të qartë dhe transparent vlerësimi, i bazuar në kontrollin e vazhdueshëm dhe i parashikuar në syllabus-in e çdo lënde. Studentët informohen</i></p>

	<p>që në fillim mbi kriteret dhe format e vlerësimit përmes platformave digjitale dhe komunikimit me pedagogët. Procesi mësimor mbështet përfshirjen aktive të studentëve përmes metodave interaktive dhe vlerësimeve të rregullta, ndërsa sugjerimet e tyre merren parasysh nëpërmjet fokus grupeve dhe mbledhjeve me departamentet. Vlerësimet shërbejnë si bazë për përmirësime në kurrikul, staf apo metodologji. Gjithashtu, stafi akademik përfshihet në trajnime të rregullta dhe shkëmbime ndërkombëtare për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare zhvillohen në përputhje me afatet e përcaktuara në Kalendarin Akademik. Provimi i ndërmjetëm organizohet rreth javës së shtatë të semestrit, ndërsa ai përfundimtar realizohet në mbyllje të tij (sipas Rregullores së UET, Neni 27, fq. 8, Ref. Nr. 5, renditur me nr. 12).</p> <p>Procesi i vlerësimit të studentëve përbëhet nga disa komponentë kryesorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimi i ndërmjetëm,</li> <li>• detyra e kursit,</li> <li>• pjesëmarrja aktive në seminare ose në detyrat praktike,</li> <li>• provimi përfundimtar.</li> </ul> <p>Provimet administrohen në kushte anonimiteti, përmes përdorimit të barkodit që fsheh emrin e studentit në fletën e provimit, deri në momentin kur provimet e korrigjuara dorëzohen në Sekretarinë Mësimore (<i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5.3 (Ref. Nr. 7) renditur nr.24; Dokumenti mbi funksionimin e sekretarisë Mësimore, pika F, 1.8.6 (Ref. Nr. 9) renditur me nr. 26</i>). Sekretimi elektronik me barkod garanton ruajtjen e identitetit dhe siguron paanshmëri në procesin e vlerësimit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, me synim rritjen e objektivitetit dhe transparencës në procesin e vlerësimit. Që prej vitit akademik 2016–2017, institucioni, në bashkëpunim me AADF (Albanian-American Development Foundation), ka zbatuar sistemin elektronik të vlerësimit “Clean Scoring” për</p>

<p>ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>testime dhe provime, si një formë bashkëkohore për kontrollin e njohurive. Gjithashtu, që nga 16 tetori 2015, përdoret programi Turnitin/Ephorus për të parandaluar plagjiaturën në ese dhe tema diplome.</p> <p><b>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5.3 (Ref. Nr.7) renditur nr.24; Dokumenti mbi funksionimin e sekretarisë Mësimore, pika F, 1.8.6 (Ref. Nr. 9) renditur me nr. 26).</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i një lënde realizohet në përputhje me syllabus-in përkatës dhe me kuadrin ligjor në fuqi, duke siguruar një proces të drejtë, të unifikuar dhe transparent për të gjithë studentët. Kjo mënyrë vlerësimi synon që rezultatet të reflektojnë me saktësi njohuritë e përvetësuar, angazhimin dhe përpjekjet individuale të studentit, mbi baza të qarta dhe objektive.</p> <p>Në varësi të natyrës së lëndës, syllabus-i përcakton përbërjen e vlerësimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Tipologjia I:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 30% provim ose detyrë,</li> <li>• 30% provim ose detyrë,</li> <li>• 40% provim përfundimtar (detyrë/projekt).</li> </ul> </li> <li>• <b>Tipologjia II:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 10% pjesëmarrje dhe aktivizim në seminare,</li> <li>• 20% detyrë kursi,</li> <li>• 30% provim i ndërmjetëm,</li> <li>• 40% provim përfundimtar.</li> </ul> </li> </ul> <p>Zbatimi i këtyre përqindjeve në përputhje me syllabus-in dhe legjislacionin garanton standarde të larta të cilësisë dhe integritetit akademik. Përmbajtja dhe vlerësimi i provimeve hartohen nga pedagogu i lëndës, ndërsa provimet përfundimtare dhe punimet e diplomës miratohen dhe vlerësohen nga komisione të posaçme të ngritura për këtë qëllim (<b>Rregullore e Programit të Studimit “BA Psikologji”, Ref. Nr. 7, nr. 24; Rregullore e UET, Ref. Nr. 5, nr. 12</b>). Në rast mosmarrëveshesh për notat, pas sqarimit paraprak me pedagogun, studenti mund t’i drejtohet me kërkesë zyrtare përgjegjësit të departamentit, i cili krijon një komision rivlerësimi me tre anëtarë; vendimi i këtij komisioni është përfundimtar (<b>Rregullore e UET, neni 32, Ref. Nr. 5, nr. 12</b>). Sekretimi i provimeve përbën një element thelbësor të sigurisë akademike dhe respektohet përmes ruajtjes së anonimatit të studentëve deri në përfundimin e procesit të korrigjimit. Gjithashtu, çdo provim zhvillohet nën mbikëqyrjen e më</p>

	<p>shumë se një pedagogu, sipas grafikut të miratuar nga departamenti përkatës (<i>Rregullore e Programit të Studimit "BA Psikologji", pika 5.3, Ref. Nr. 7, nr. 24; Dokumenti E.I "Mbi funksionimin e Sekretarisë Mësimore", pika E.I.8.6, Ref. Nr. 9, nr. 26).</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të përmirësuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Forma dhe mënyrat e vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale e shkencore të studentëve realizohen në mënyra të ndryshme, duke i dhënë atyre mundësinë të shprehin sa më mirë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor (<i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5. (Ref. Nr.7) renditur nr.24;</i>). Rregullorja parashikon disa forma alternative të kontrollit të njohurive, që mund të zgjidhen nga pedagogu sipas natyrës së lëndës dhe që lejojnë vlerësimin sa më të saktë të rezultateve të synuara të të nxënës.</p> <p>Kombinimi i komponentëve të ndryshëm të vlerësimit, siç evidentohet edhe nga fokus-grupet me studentë, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e përvojës studentore, duke shpërndarë ngarkesën mësimore dhe duke siguruar një proces vlerësimi të vazhdueshëm e gjithëpërfshirës.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Plagjiatura dhe kopjimi përbëjnë shkelje të rëndë akademike. Plagjiatura ndodh kur studentët paraqesin si punë të tyre materiale të huaja pa citim, qoftë të paprekura apo të përshtatura. Nëse konstatohet plagjiaturë në ese ose diplomë, studenti ndëshkohet automatikisht me notën 4 në lëndën përkatëse, pavarësisht performancës në pjesë të tjera të vlerësimit.</p> <p>Gjithashtu, kopjimi gjatë provimit — qoftë nga materiale të shkruara, nga provimi i një studenti tjetër apo përmes komunikimit — çon në ndërprerjen e provimit dhe vlerësimin me notën 4 (<i>Rregullore e UET, Neni 33, pika 33.1 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12).</i></p> <p>Telefonat celularë janë të ndaluar gjatë provimeve dhe duhet të jenë të fikur. Në rast përsëritjeje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Herën e dytë, studenti shënohet në regjistrin e Këshillit të Etikës dhe paralajmërohet për përjashtim.</li> <li>• Herën e tretë, përjashtohet nga Universiteti dhe humbet çdo të drejtë financiare që i takon nga kontrata me UET-in.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe</p>	<p>Procesi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve në Universitetin Europian të Tiranës bazohet në</p>

<p>aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>parimin e vlerësimit të vazhdueshëm dhe në meritokraci. Studentët informohen që në fillim të lëndës për format, komponentët dhe peshën përkatëse të vlerësimit, të përcaktuara në syllabus. Vlerësimi realizohet në forma të ndryshme — përmes detyrave të ndërmjetme, pjesëmarrjes aktive, projekteve dhe provimit përfundimtar — duke i dhënë studentit mundësi të shprehë sa më mirë kompetencat e fituara. Larmia e metodave të përdorura i jep pedagogut fleksibilitet për të zgjedhur mënyrën që përshtatet më së miri me natyrën e lëndës. Rezultatet e provimeve dorëzohen brenda dy javëve (<i>Rregullore e UET, Neni 27, pika 9, fq. 8 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>) nga data e zhvillimit të tyre, ndërsa në rastin e riprovimeve, për shkak të numrit më të vogël të studentëve, afati për dorëzimin e notave është një javë (po aty). Të gjitha provimet korigjohen në mënyrë anonime, duke garantuar objektivitet. Vlerësimi i komponentëve të tjerë duhet të dorëzohet përpara provimit përfundimtar dhe nuk mund të ndryshohet pas shpalljes së rezultateve.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të kërkojnë rishikimin e vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara. Informimi mbi rezultatet bëhet në kohë reale përmes sistemit online, duke garantuar transparencë dhe akses të menjëhershëm ndaj të dhënave të vlerësimit (<i>Rregullore UET, neni 32, pika 9, fq.8 (Ref. Nr. 5) renditur nr. 12</i>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Pas përfundimit të provimit, çdo kërkesë apo ankesë në lidhje me vlerësimin shqyrtohet fillimisht nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga një komision i posaçëm tre anëtarësh, ku nuk përfshihet pedagogu i lëndës. Ky komision merr vendim për vlefshmërinë e vlerësimit dhe ndërmerr veprimet përkatëse. Në rast ankese për ndonjë komponent të vlerësimit, pasi studenti ka ndjekur procedurën e sqarimit me pedagogun, ai i drejtohet me kërkesë me shkrim Përgjegjësit të Departamentit. Pas marrjes së kërkesës, ngrihet një komision rivlerësimi, i cili jep vendim përfundimtar, i cili mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar (<i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5.8 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i>). E gjithë procedura dokumentohet dhe arkivohet sipas rregullores (<i>Rregullore UET, neni 32, pika 9, fq.8 (Ref. Nr. 5) renditur nr. 12</i>).</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Procesi i vlerësimit në Universitetin Europian të Tiranës bazohet në meritokraci dhe kontroll të vazhdueshëm, duke</i></p>

	<p><i>përfshirë komponentë si provimet, detyrat e kursit dhe pjesëmarrjen aktive. Provimet administrohen në kushte anonimiteti përmes sistemit me barkod dhe korigjohen në mënyrë të paanshme. Studentët informohen në kohë reale për rezultatet dhe kanë të drejtë të kërkojnë rishikim të vlerësimit, përmes procedurave të qarta që përfshijnë komisione të posaçme. Respektohen standardet për parandalimin e plagjiaturës dhe shkeljet ndëshkohen sipas shkallës së përsëritjes. Sistemi i vlerësimit garanton transparencë, drejtësi dhe përshtatje me natyrën e lëndës, duke i dhënë studentëve mundësi të shprehin më mirë njohuritë dhe aftësitë e fituara.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p><b>Standardi III.4</b>  <b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b></p>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Kurrikula e programit të studimit është hartuar në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushën e psikologjisë, duke synuar aftësimin e studentëve me njohuri teorike dhe praktike, në funksion të kërkesave të tregut të punës dhe avancimit akademik (<i>Plani strategjik për zhvillimin e programit Ba Psikologji (Ref. Nr. 4) renditur nr. 11</i>). Programi garanton përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive kërkimore në përputhje me rezultatet e të nxënit. Këto përfshijnë: analizën konceptuale dhe teorike të fushës, aftësi kërkimore drejt ciklit të tretë të studimit, dhe formim të përgjithshëm kërkimor (<i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit synon zhvillimin e aftësive teorike, humane, sociale dhe të ndërveprimit (<i>Kurrikula e programit Ba Psikologji (ref. Nr. 14) renditur nr. 44</i>), përmes punës në grup dhe diskutimeve. Ai është licencuar në gjuhën shqipe, por UET synon që deri në vitin 2025 të ofrojë deri në 25% të kurrikulës në anglisht, për të nxitur ndërkombëtarizimin dhe tërheqjen e studentëve të huaj (<i>Plani Strategjik UET 2021 – 2025, pika 1.2, f. 4 (Ref. Nr. 3.2), renditur me nr. 8</i>). Studentët Erasmus kanë mundësi të ndjekin disa lëndë në gjuhë të huaj. Gjithashtu, ofrohen edhe lëndë “Honors course” nga pedagogë me tituj shkencorë, të cilat mund të zhvillohen</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>në shqip ose anglisht, në varësi të ekspertizës (<i>Rregullore e UET, Neni IV, pika 9, neni 16.3, fq.5 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>). Duke marrë në konsideratë lëvizjen e të diplomuarve dhe punësimin e tyre në vendet europiane dhe aplikohet më tej për plotësimin e kritereve sipas standarteve të Euro-Psy.</p>
<p><b>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</b></p>	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të fushës së psikologjisë dhe synon të pajisë studentët me njohuri teorike e praktike, aftësi kërkimore dhe kompetenca të nevojshme për tregun e punës dhe avancimin akademik (<i>Syllabuset e Lëndëve (Ref. Nr. 19) renditur me nr. 51</i>). Ai nxit punën në grup, diskutimin, dhe trajtimin e çështjeve përmes një qasjeje ndërdisiplinore, duke përfshirë lëndë në gjuhë të huaj si pjesë e ndërkombëtarizimit. Syllabuset për secilën lëndë përmbajnë qartësisht objektivat, kompetencat dhe format e vlerësimit. Vlerësimi i studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe rezultatet analizohen nga departamenti për përmirësime të mundshme. Studentët diplomohen me një gamë të gjerë aftësish që i përgatisin për tregun e punës ose për vazhdimin e studimeve në nivel më të lartë.</p>
<p><b>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</b></p>	<p>Programi i studimit mbështetet në mësimdhënie të bazuar në kompetenca, ku përfshihen detyra kursi (20% e vlerësimit) (<i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5.2, fq.3 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i>), praktika profesionale (<i>Dokumenti 8.1 mbi praktikën profesionale (Ref. nr.32.1) renditur me nr. 85</i>) dhe integrimi i teorisë me praktikën. Studentët angazhohen në diskutime, punë në grup dhe analiza rastesh gjatë orëve mësimore (<i>Rregullore e UET, Neni 1 26, fq.7 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12; Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, pika 5.7.2, fq.5 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i>). Personeli akademik mbështet zhvillimin e njohurive dhe është i përfshirë në kërkimin shkencor, publikime dhe bashkëpunime institucionale. Programi synon përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe avancimin akademik, duke garantuar standarde bashkëkohore (<i>Plani Strategjik UET 2021 - 2025 (Ref. Nr. 3.2), renditur me nr. 8</i>) të arsimit dhe ndërkombëtarizimit.</p>

mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.				
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Në përputhje me kalendarin vjetor, lektorët organizojnë orë të hapura dhe seminare me të ftuar nga fusha akademike dhe profesionale, për të diskutuar zhvillimet më të fundit në fushën përkatëse (Kalendar i aktiviteve të departamentit (Ref. nr. 55.2), renditur me nr. 139, referenca reale është 55). UET ka marrëveshje bashkëpunimi me kompani, që mundësojnë përfshirjen e profesionistëve në trajnime dhe leksione të hapura për studentët (Marrëveshje bashkëpunimi-Lista UET (Ref. nr. 34, 34.1, 34.6) renditur me nr. 87, 88,89,90).</p> <p><i>Evidenca 55.22: Kalendar i aktiviteve të departamentit;</i> <i>Evidenca 34, 34.1,34.6: Marrëveshje bashkëpunimi-Lista UET</i></p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit në fushën e psikologjisë është ndërtuar në përputhje me zhvillimet akademike dhe kërkesat e tregut të punës, duke synuar përvetësimin e njohurive teorike, praktike dhe kërkimore nga studentët. Ai mbështetet në një qasje të integruar ndërdisiplinore, ku përfshihen mësimdhënia në gjuhë të huaj, detyrat praktike, puna në grup dhe vlerësimi i vazhdueshëm i kompetencave. Programi nxit ndërkombëtarizimin dhe përfshirjen aktive të stafit akademik në kërkimin shkencor dhe bashkëpunimin institucional por ka ende hapësirë për të plotësuar kriteret mbi njohjen e diplomave të tyre në komunitetin Europian nëpërmjet Euro-Psy. Gjithashtu, ofrohen orë të hapura dhe seminare me profesionistë të fushës për të ndërlidhur teorinë me zhvillimet aktuale në praktikë.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi III.5</b> <b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblylëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet	Institucioni përcakton një procedurë të veçantë për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës, e cila bëhet publike në fillim të semestrit ( <i>Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji, Neni 8, pika 1, fq. 6 (Ref. Nr.7) renditur nr.24</i> ). Për të përfunduar studimet, studenti duhet të kalojë një provim të përgjithshëm përmblylës ose të mbrojë një punim diplome në përputhje me fushën e programit. Universiteti

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>informon studentët për mundësinë e realizimit të punimit të diplomës dhe për procedurat përkatëse përmes rregullores apo njoftimeve elektronike.</p> <p><b>Evidenca 7: Rregullore e Programit të studimit Ba Psikologji</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik u ofrojnë studentëve mbështetje përmes seancave metodologjike, sipas një kalendari të shpallur më parë, duke i pajisur me informacion, udhëzime dhe materiale të nevojshme për provimin final dhe mbrojtjen e diplomës. Dokumenti B.II "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit" përshkruan në mënyrë të detajuar të gjitha procedurat, nga aplikimi dhe miratimi i temës, deri te formatimi dhe mbrojtja përpara komisionit (<i>Dokumenti B.II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit (Ref. Nr. 10) renditur me nr. 27</i>). Ky informacion u vihet në dispozicion studentëve përpara aplikimit për temën e diplomës. Studentët që zgjedhin të kryejnë një punim diplome, janë të detyruar ta mbrojnë atë përpara një komisioni të ngritur nga departamenti përkatës (<i>Rregullore e UET, Neni 39, fq.10 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>).</p> <p><b>Evidenca 10: Dokumenti B.II "Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit";</b> <b>Evidenca 5: Rregullore e UET</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në programin "Bachelor në Psikologji", studentëve u jepet mundësia të përmbyllin studimet me një temë diplome ose përmes provimit përfundimtar, i cili përmban 10 pyetje nga lëndët bazë të programit. Mbrojtja e temës synon të vlerësojë aftësinë për të aplikuar njohuritë teorike në një rast konkret studimor (<i>Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A. IV. 2.3, fq.1, (Ref. Nr. 7.2) renditur me nr. 20; Rregullore e UET, Neni 39, pika 1.b, fq.10 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12</i>). Studentët orientohen që herët mbi procedurat për secilën formë përmbylljeje përmes një programi të detajuar informues. Kriteret e përzgjedhjes për temën e diplomës përfshijnë edhe performancën akademike gjatë studimeve (po aty).</p> <p><b>Evidenca 7.2: Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve; Evidenca 5: Rregullore e UET</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe</p>	<p>Personeli akademik ofron orientim dhe mbështetje për studentët si në përgatitjen për provimin përfundimtar, ashtu edhe në përzgjedhjen dhe zhvillimin e temës së diplomës,</p>

<p>ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>përmes seancave metodologjike dhe tutoriatit akademik (<i>Dokumenti për sistemin e vlerësimit të studentëve, pika A. IV. 2.3, fq.1, (Ref. Nr. 7.2) renditur me nr. 20; Rregullore e UET, Neni 39, pika 1.b, fq.10 (Ref. Nr. 5)</i>). Gjatë shqyrtimit të propozimeve për temat e diplomës, departamenti siguron që udhëheqësi i propozuar nga studenti të jetë në përputhje me fushën e programit dhe temën. Në rast mungese përputhshmërie, caktohet një pedagog udhëheqës i përshtatshëm nga departamenti. Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të kualifikuar për një temë të caktuar, mund të caktohet një pedagog i jashtëm që plotëson kriteret e nevojshme.</p> <p><i>Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit pika 4.1, fq 33 (Ref. Nr. 10) renditur me nr. 27)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Gjatë seancave metodologjike, pedagogu udhëheqës trajton çështje që lidhen me aspektet metodologjike të punimit të diplomës, përpunimin e të dhënave përmes metodave sasiore dhe cilësore, si dhe organizimin e punës në terren. Ai udhëzon studentin në planifikimin, zbatimin dhe raportimin e gjetjeve apo të dhënave të studimit.</p> <p><i>Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit pika 5.2, fq 34 (Ref. Nr. 10) renditur me nr. 27)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti që ka përmbytur të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe detyrimet ndaj institucionit, pajiset nga UET-i me diplomën përkatëse brenda një afati prej gjashtë muajsh. Diploma shoqërohet me certifikatën e notave dhe suplementin e diplomës, të firmosura nga Dekani dhe Sekretari i Përgjithshëm. Deri në momentin e lëshimit të diplomës, studenti pajiset me një vërtetim zyrtar dhe certifikatën përkatëse të notave.</p> <p><i>Rregullore e UET, Neni 40, pika 1, fq.11 (Ref. Nr. 5), renditur me nr. 12.</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje</p>	<p>Studentët kanë të drejtën të kërkojnë rishikimin e vlerësimit të provimit, në përputhje me rregulloret dhe procedurat përkatëse. Informimi mbi rezultatet e vlerësimit bëhet në kohë reale përmes sistemit online. Për orarin e seancës sqaruese, studenti njoftohet nga koordinatori i programit ose nga vetë pedagogu përmes platformës LMS. Gjatë kësaj seance, pedagogu u jep studentëve mundësinë të rishikojnë testin dhe të marrin shpjegime mbi përgjigjet e dhëna dhe elementët e vlerësimit.</p>

e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në rast se studenti, pas seancës sqaruese, ka ankesë mbi vlerësimin e ndonjë komponenti të provimit, ai ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë të argumentuar me shkrim Përgjegjësit të Departamentit (ose Dekanit, kur pedagogu është vetë përgjegjësi i departamentit), për rivlerësim. Në vijim, ngrihet një komision ad hoc i përbërë nga tre pedagogë për të shqyrtuar kërkesën dhe për të rivlerësuar komponentin përkatës. Vendimi i komisionit, i marrë me shumicë votash, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i kontestuar ( <b>Dokumenti B. II. Mbi punimin e diplomës dhe disertacionit pika 1,2,3, fq 43 (Ref. Nr. 10) renditur me nr. 27).</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Pas përfundimit të studimeve, dokumentacioni i studentit arkivohet dhe ruhet pa afat. Institucioni mban një databazë të plotë me të dhënat e studentëve dhe përpunon statistika sipas kërkesave zyrtare. Zyra e kontratave dhe sekretaria ruajnë dokumentacionin në përputhje me rregulloret dhe afatet përkatëse. <b>Evidenca 5: Rregullore e UET;</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni i arsimit të lartë përcakton dhe publikon procedurat për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës që në fillim të semestrit. Studentët përfundojnë studimet duke kaluar një provim të përgjithshëm ose duke mbrojtur një punim diplome, sipas fushës së programit. Universiteti dhe stafi akademik ofrojnë mbështetje përmes seancave metodologjike dhe udhëzimeve zyrtare, përfshirë miratimin e temës dhe përgatitjen për mbrojtje. Për programin "Bachelor në Psikologji" ofrohen dy alternativa për përfundimin e studimeve: provimi përfundimtar ose tema e diplomës. Pas përfundimit të studimeve, studentët pajisen me diplomë dhe dokumentacion përkatës, ndërsa të dhënat e tyre arkivohen dhe ruhen pa afat.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>
<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,  
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>							
<b>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>							
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>						
<b>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</b>	Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Psikologji” me profil “Shëndet Mendor”, përmbush kërkesat ligjore në fuqi.  <i>Niveli i kualifikimit për stafin akademik që jep mësim në këtë program studimi Bachelor në “Psikologji” me profil “Shëndet Mendor” është si me poshtë:</i>						
	<b>Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit</b>	<b>2022-2023</b>		<b>2023-2024</b>		<b>2024-2025</b>	
		<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>	<b>PAE</b>	<b>PAK</b>
	<b>Prof. Dr</b>	1	-	1	-	2	-
	<b>Prof. As. Dr</b>	1	-	2	-	4	-
	<b>Dr.</b>	9	-	9	1	7	-
	<b>MSc (asistentë)</b>	8	1	6	-	6	1
	<b>Total</b>	<b>19</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>1</b>	<b>19</b>	<b>1</b>
	<i>Referuar tabelave rvb (tab. 6.1), evidenca nr. 2.</i>						
	Zyra e Burimeve Njerëzore administron dosjet që përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm të personelit efektiv dhe atij me kontratë duke i përditësuar ato vazhdimisht. Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit është me grada shkencore dhe tituj, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, si edhe ka ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar. Kualifikimet dhe eksperiencat e tyre profesionale përputhen me modulën që angazhohen. Referuar edhe pikës G.II.2.3. të Dokumentit “G. BURIMET NJERËZORE” kushtet bazë për përcaktimin e lëndëve që do të zhvillojë anëtari i personelit akademik janë: a. Ekspertiza akademike dhe kërkimore e anëtarit të personelit. b. Përvoja në fushën e mësimdhënies. c. Afërsia dhe lidhja organike e lëndëve në fjalë, ose qenia e tyre vijim i njëra – tjetrës.						

	<p>Detyrat dhe të drejtat e stafit drejtues, mësimdhënës, janë përcaktuar në Statutin, Rregulloret e institucionit, Kodin e Etikës dhe Kodin e Integritetit akademik, në dokumentet mbështetëse si dhe në kontratat individuale të punës dhe anekseve të kontratave. Personeli akademik angazhohet për kualifikimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional duke marrë pjesë në aktivitete të vetë institucionit si dhe në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit për të mbështetur përparimin akademik dhe rritur cilësinë në mbulimin e programit të studimit.</p> <p><b>Referenca 46: Referuar Kodi I Etikës</b> <b>Referenca 2: Tabelat RVB</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore dhe rregulloret në fuqi. Shpërndarja e ngarkesës nga drejtuesi i departamentit, realizohet në mënyrë të balancuar, duke respektuar standardet e përcaktuara për numrin e orëve të mësimdhënies, konsultimeve dhe aktiviteteve të tjera akademike, në përputhje me pozicionin akademik dhe normat institucionale. <i>Referuar Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore, pika G.II.4.1, fq. 4 (Ref. Nr. 11)</i>, Ngarkesa mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit, Aneks Tabela 12. Institucioni siguron që çdo lëndë e planifikuar në kurrikulë të mbulohet nga staf i kualifikuar dhe me profil të përshtatshëm, duke garantuar cilësinë dhe vazhdimësinë e procesit mësimor. Përveç përmbushjes së detyrimeve ligjore, vëmendje i kushtohet edhe ngarkesës së arsyeshme të stafit, në mënyrë që të ruhet efikasiteti, angazhimi dhe cilësia e mësimdhënies.</p> <p><i>Duke u bazuar në tabelën 12 (aneks tabelave të rvb), personeli akademik efektive (PAE) e mbulon mbi 70 % ngarkesën mësimore sipas kuadrit ligjor. Për vitin akademik 2024-2025: 93% PAE/ 6,8 % PAK.</i></p> <p><b>Referuar (nr.11): Rregullores për Burimet Njerëzor</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe</p>	<p>Institucioni garanton dhe dokumenton qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit për të gjithë periudhën e akreditimit. Stafi akademik angazhohet në bazë të kontratave të rregullta pune, të cilat përmbajnë të gjitha elementet ligjore për një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të mbrojtur. Të gjithë anëtarët e personelit akademik janë të mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe sigurime suplementare në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni ruan dokumentacionin përkatës në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe është në gjendje të dëshmojë vazhdimësinë e stafit përmes dosjeve individuale të punësimit dhe evidencës së përditësuar të</p>

<p>mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>kontratave. Për personelin akademik me kohë të pjesshme, kontrata e punës është me afat semestral me të drejtë përsëritje sipas vullnetit të palëve. Kjo siguri kontraktuale dhe mbulimi me sigurime kontribuon në motivimin e stafit, stabilitetin e programit dhe garantimin e cilësisë në mësimdhënie gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit.</p> <p><b>Referuar (nr. 7): Rregullore Mësimore BA Psikologji.pdf</b>  <b>Referuar (nr.11): Rregullores për Burimet Njerëzor</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura të qarta, të dokumentuara dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit akademik, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme. Thirrjet për aplikim publikohen në faqen zyrtare të institucionit dhe në platforma të tjera zyrtare, duke përfshirë të gjitha kriteret e përgjithshme dhe specifike të përzgjedhjes. Këto procedura janë të përcaktuara në dokumentet e brendshme të institucionit. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore. Referuar rregullores për Burime Njerëzore. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Procesi i rekrutimit realizohet në disa faza:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapja e konkurseve dhe pranimi i aplikimeve brenda afateve të përcaktuara;</li> <li>• Verifikimi i dokumentacionit dhe përmbushjes së kritereve nga aplikantët;</li> <li>• Vlerësimi nga një Komision i Posaçëm, i ngritur me vendim të institucionit, i cili shqyrton CV-të, kualifikimet, përvojën akademike dhe shkencore, si dhe përputhjen me kërkesat e modulit apo programit të studimit;</li> <li>• Intervista dhe/ose prova e mësimdhënies;</li> <li>• Përzgjedhja dhe emërimi përfundimtar, i cili pasqyrohet në kontratën e punës.</li> </ul> <p>Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me Statutin dhe Rregulloren UET. Referuar rregullores për burimet njerëzore. Personeli i përzgjedhur mbulon modulet në përputhje me strukturën dhe objektivat e programit të studimit. Institucioni gjithashtu zhvillon vlerësime të rregullta të performancës së stafit akademik, përmes</p>

	<p>anketave studentore, vlerësimeve të brendshme dhe analizave të ngarkesës mësimore, në mënyrë që të sigurojë standarde të larta cilësie dhe të identifikojë nevojat për zhvillim profesional të vazhdueshëm.</p> <p><b>Referuar (nr.11): Rregullores për Burimet Njerëzor</b></p> <p><b>Referuar (nr.5): Statutit UET</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike me mjetet dhe programet aplikative të nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e standarteve sasiore dhe cilësore për zhvillimin e procesit mësimor për aftësimin teorik e praktik sipas natyrës specifike të programit të studimit dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore. Është treguar dhe tregohet kujdes për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe paisjeve të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Secili anëtar i stafit akademik ka dosje individuale të krijuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore që mbledh dhe përditëson të dhënat e personelit akademik Referuar të dhënave tabelore për personelin akademik në programin studimit ndër vite Dosja përmban të dhëna që përcaktohen nga Dokumenti G. Rregullore për Burimet Njerëzore që vlen për stafin me kohë të pjesshme dhe të plotë Referuar listës së dokumentacionit të dosjes_Staf Akademik me Kohë të Plotë (Ref. Nr. 44.1); Listë e dokumentacionit të dosjes_Staf Akademik me Kohë të Pjesshme (Ref. Nr. 44.2) Gjithashtu, kjo zyrë mban evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik, referuar ngarkesave mësimore në auditor e stafit akademik, të angazhuar në programin e studimit, <i>Aneks Tabela 12 (Ref. Nr. 25)</i> për çdo semestër e specifikuar po ashtu nga Dokumenti G pika G.II. Referuar rregullures së burimeve njerëzore.</p> <p>Drejtuesi i Departamentit harton dhe shpërndan ngarkesën mësimore të secilit anëtar të personelit akademik që janë pjesë e departamentit që drejton. Referuar dokumentit F.IV-F.V Mbi organizimin dhe funksionimin e Dekanatit dhe Departamentit, F. V.4.6/c. (Ref. Nr.6) Në përfundim të çdo viti akademik, Drejtuesi i departamentit mban të dhëna tabelore, për anëtarët e personelit akademik, të angazhuar në secilin nga programet që buron nga departamenti i tij. Çdo anëtar i stafit akademik përditëson dosjen duke raportuar zhvillimet mbi</p>

	<p>kërkimin shkencor që merr përsipër, projektet e realizuara gjatë vitit akademik, pjesëmarrjen në konferencat shkencore, etj.</p> <p><b>Referuar(nr.11): Rregullores për Burimet Njerëzor</b>  <b>Referuar(nr.41): formular i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik .pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar memorandume dhe marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani dhe institucione. <b>Referuar Marrëveshjeve të bashkëpunimit-lista UET (Ref. Nr. 34)</b> Institucioni, nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, biznese, kompani dhe organizata partnere, siguron një rrjet të qëndrueshëm mbështetjeje për zhvillimin e praktikës profesionale, realizimin e temës së diplomës dhe angazhimin në veprimtari të tjera të lidhura me profilin e programit të studimit.</p> <p>Për këto qëllime, institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe të përshtatshëm, i cili angazhohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Instruktimin dhe udhëheqjen e studentëve gjatë praktikës profesionale</b>, duke siguruar që përvoja praktike të jetë në përputhje me objektivat e programit;</li> <li>• <b>Mbikëqyrjen e punimeve të diplomës</b>, përmes caktimit të udhëheqësve akademikë me përvojë dhe profil të përshtatshëm;</li> <li>• <b>Bashkëpunimin me mentorë në terren</b>, të cilët janë pjesë e institucioneve pritëse (biznese, klinika, shkolla, kompani IT, laboratorë etj.), dhe që luajnë rol të rëndësishëm në orientimin profesional të studentëve.</li> </ul> <p>Këto marrëveshje janë të formalizuara përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, dhe përditësohen periodikisht. Institucioni ndjek nga afër ecurinë e praktikave dhe angazhimin e personelit përgjegjës, përmes mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, në mënyrë që të sigurojë cilësinë dhe efektivitetin e përvojës së fituar nga studentët. Gjithashtu, departamenti vë në dispozicion personel akademik efektiv për instruktimin dhe udhëheqjen e punimit të diplomës dhe studentët mund të përzgjedhin se me cilin prej pedagogëve dëshirojnë të zhvillojë punimin shkencor, duke harmonizuar idetë për punimin dhe fushën e ekspertizës së vet udhëheqësit.</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave</p>	<p>Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, luan një rol aktiv dhe thelbësor në realizimin e praktikave profesionale. Ky personel është përgjegjës jo vetëm për</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>orientimin dhe monitorimin e përditshëm të studentëve gjatë periudhës së praktikës, por gjithashtu, merr pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës profesionale, përmes formularëve të strukturuar të feedback-ut, që i dorëzohen institucionit të arsimit të lartë për qëllime dokumentimi dhe verifikimi të cilësisë.</p> <p><b>Referuar Dokumenti B.I Mbi praktikën profesionale pika B. I, fq 1 (Ref.Nr.32.1) Ky formular bëhet pjesë e dosjes s vlerësimit të studentit nga komisioni vlerësues.</b></p>			
<p><b>Konkluzionet</b></p>	<p>Në bazë të gjetjeve të mësipërme, pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit. Gjithashtu, departamenti vë në dispozicion personel akademik efektiv për instruktimin dhe udhëheqjen e punimit të diplomës. Ky personel është përgjegjës jo vetëm për orientimin dhe monitorimin e punimeve të diplomës por edhe për monitorimin e studentëve gjatë periudhës së praktikës, duke marrë pjesë në procesin e vlerësimit të praktikës profesionale. Zyra e burimeve njerëzore përditëson në kohë dosjet e personelit akademik të cilat reflektohen në aktivitetin e kësaj zyre. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimit e personelit akademik në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e institucionit të Arsimit të Lartë.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi IV.2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>UET garanton zhvillimin e veprimtarisë mësimore në mjedise të përshtatshme, të mirëorganizuar dhe në përputhje me kërkesat e natyrës së programit të studimit. Infrastruktura fizike dhe logjistike është ndërtuar dhe menaxhohet në mënyrë të tillë, që të përmbushë nevojat e studentëve dhe stafit akademik, duke mbështetur standardet e cilësisë në procesin mësimor. Institucioni ka në dispozicion 18 salla për seminare - 493 vende, 14 salla leksioni – 1068 vende, 7 laboratorë informatike – 190 vende, 1 sallë interneti – 70 vende, referuar Infrastruktura</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail/ info@ascal.al

	<p>në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”, fq.1-2 (Ref. Nr. 42) të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore didaktike (projektorë, rrjet interneti, sistem audio etj.). Këto hapësira janë të planifikuara në përputhje me: numrin total të studentëve të regjistruar; numrin e grupeve mësimore dhe specifikat e ndarjes në seminare ose laboratorë etj. Të gjitha ambientet mësimore janë të aksesueshme për studentët gjatë orareve të përcaktuara. Institucioni ka një strukturë të dedikuar për mirëmbajtjen e infrastrukturës, e cila monitoron dhe kujdeset për funksionimin optimal të çdo hapësire, në mënyrë që të mos cenohet cilësia e procesit mësimor.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Të gjitha mjediset e punës dhe ato mësimore të UET janë të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni për zhvillimin normal të procesit mësimor. <i>Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”, fq.1-2 (Ref. Nr. 42).</i> Sistemi i kondicionimit ndodhet në çdo ambient në UET. Mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht webin dhe platformat online LMS dhe Microsoft TEAMS për shpërndarjen e materialeve mësimore, komunikimin me studentët dhe zhvillimin e vlerësimeve online. Pajisjet dhe infrastruktura në dispozicion vlerësohen të përshtatshme dhe në përputhje me qëllimet dhe nevojat e zhvillimit të mësimdhënies. <b>Ref. Nr.42. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Institucioni siguron që laboratorët, studiot, palestrat dhe mjediset e tjera praktike, të jenë të pajisura me aparaturat, instrumentet dhe materialet e nevojshme në përputhje me kërkesat specifike të moduleve dhe natyrën e programeve të studimit. Pajisjet janë të zgjedhura dhe të mirëmbajtura në mënyrë që të mundësojnë zhvillimin e aftësive teorike dhe praktike të studentëve dhe realizimin e objektivave formues të parashikuara në program. Çdo program studimi që përfshin komponentë praktikë zhvillohet në mjedise të dedikuara, të cilat janë: Të pajisura me aparatura funksionale dhe mjete ndihmëse që u mundësojnë studentëve të punojnë në kushte të ngjashme me ato të praktikës profesionale; Të mbështetura nga stafi akademik, që garanton përdorimin e drejtë, të sigurt dhe efektiv të tyre gjatë veprimtarive mësimore. Për çdo modul që zhvillohet në këto ambiente, hartohen udhëzime të qarta didaktike dhe parashikohen orë specifike për punë praktike në planin mësimor.</p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit që asistojnë studentët e programit Bachelor në Psikologji.</p> <p>UET disponon InnoLab, pjesë e një projekti (Innovation Hub) të ideuar dhe zbatuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të financuar nga Programi Italo-Shqiptar i Konvertimit të Borxhit për Zhvillim IADSA, i dedikuar për studentët si dhe për aktivitete të lidhura me natyrën e programit të studimit. Laboratori i Inovacionit është i pajisur me PC dhe vidioprojektor. Gjithashtu UET ka dhe laboratorin e VR-AR, ku studentët mund të programojnë për të realizuar shërbime të tilla në teknologjinë virtuale.</p> <p>Institucioni disponon një sërë laboratorësh të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor.</p> <p>Aktualisht në ambjentet e UET ekzistojnë: 7 laboratorë informatike të paisur me PC dhe videoprojektorë. <i>Referuar infrastruktura në funksion të zhvillimit të programeve të studimit, – Rr. “Xhanfize Keko” fq. 2 (Ref. Nr. 42)</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Si konkluzion institucioni e përmbush plotësisht standartin pasi disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit që asistojnë studentët e programit Bachelor në Psikologji. Institucioni disponon laboratorë të teknologjisë së informacionit që asistojnë studentët e programit Bachelor në Psikologji. Të gjitha ambientet mësimore janë të aksesueshme për studentët sipas orareve të përcaktuara. Infrastruktura fizike dhe logjistike është ndërtuar dhe menaxhohet në mënyrë të tillë, që të përmbushë nevojat e studentëve dhe stafit akademik, duke mbështetur standardet e cilësisë në procesin mësimor.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

**Standardi IV.3**

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në	Biblioteka e UET disponon literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>mësimore përkatëse. Fakulteti i Shkencave Humane, Edukimit dhe Arteve Liberale, ka pasuruar vazhdimisht bibliotekën me libra në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për programin e studimit.</p> <p>Ekziston salla e bibliotekës 40 m<sup>2</sup> dhe salla e leximit 50 m<sup>2</sup> me 41 vende leximi. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online Sage&amp;EBSCO, Questia, ASTM Compass, Edward Elgar Publishing – Elgar Online Platform, RESEARCH4LIFE, në të cilat është abonuar institucioni.</p> <p><i>Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit.</i></p> <p><i>Pavarësisht pasurimit me literaturë të huaj, sugjerohet shtimi i burimeve në gjuhën shqipe, veçanërisht për një program me fokus në shëndetin mendor dhe përgatitjen profesionale në kontekstin shqiptar.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit komunikon me Përgjegjësën e Bibliotekës për përditësimin dhe pasurimin e fondit të Bibliotekës me literaturën e nevojshme, për një zhvillimin normal të procesit mësimor dhe të veprimtarisë kërkimore shkencore në UET. Personeli akademik, në përputhje me nevojat e tij akademike e shkencore, bën prezent kërkesat tek Drejtuesi i Departamentit përkatës, i cili dërgon kërkesën përmbledhëse tek Përgjegjësi i Bibliotekës [formati E.IV.2]. Për blerjen e librave nevojitet miratimi i Administratorit. Numri i kopjeve të çdo materiali të ri, që hyn në Bibliotekë, nga Departamenti duke marrë për bazë llojin e botimit dhe nevojat për të, si edhe kërkesat e studentëve.</p> <p><b><i>Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E IV.3.2 fq.1 (Ref. Nr. 45.1)</i></b></p> <p><b><i>Formular për pasurimin e literaturës në bibliotekë (Ref.Nr.45.2)</i></b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ofron bibliotekën mësimore për studentët, duke siguruar akses të barabartë për të gjitha burimet dhe materialet e disponueshme. Biblioteka mësimore përmban një koleksion të pasur librash, revistash, botimesh shkencore dhe burimesh digjitale që mbështesin programet e studimit dhe kërkesat akademike të studentëve. Ekziston salla e bibliotekës 40 m<sup>2</sup> dhe salla e leximit 50 m<sup>2</sup> me 41 vende leximi. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të aksesojnë bibliotekat online në të cilat është</p>

	<p>abonuar institucioni. <i>Referuar Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”, fq. 2 (Ref. Nr. 42.1)</i></p> <p>Për të siguruar mundësinë e shfrytëzimit të barabartë, institucioni ka implementuar një sistem të menaxhimit të përdorimit të bibliotekës, që mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Akses të drejtpërdrejtë dhe të përshtatshëm për studentët, sipas programit të studimit;</li> <li>• Përditësimin e literaturës dhe sigurimin e materialeve të nevojshme në përputhje me përmbajtjen e programeve akademike dhe kërkesat e fushave përkatëse;</li> <li>• Përdorim të lehtë dhe të qasshëm të burimeve bibliotekore digjitale</li> </ul> <p>Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përshtatshme për natyrën dhe specifikën e programit të studimit. <i>(Referuar Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës).</i></p> <p>Në fondin e Bibliotekës së UET ka tituj të botuar nga UET - Press, të autorëve shqiptarë ose përkthime. UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në syllabuset e çdo lënde. Biblioteka kishte një fond titujsh të regjistruar në katalogun online në shqip dhe gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht).</p> <p>Biblioteka funksionon me orar të gjatë, ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Në burime elektronike biblioteka ka akses në katër platforma elektronike të cilat janë: 1. SAGE 2. EBSCO 3. Edward Elgar Publishing 4. ASTM Compass. <i>Referuar Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”, fq. 3 (Ref. Nr. 42)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online</p>	<p>Biblioteka është e pajisur me PC dhe mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi duke mundësuar akses pa kufizim dhe falas për studentët në shërbimin e bibliotekës virtuale. <i>(Referuar Dokumenti E-</i></p>

<p>të fushës së programit të studimit.</p>	<p><i>IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.3, fq.1 (Ref. Nr. 45.1)</i></p> <p>Aksesi i lirë në këto burime është një element thelbësor i mbështetjes akademike dhe kërkimore, duke i mundësuar studentëve të thellojnë njohuritë përtej literaturës bazë dhe të qëndrojnë të informuar mbi zhvillimet më të fundit shkencore ndërkombëtare. UET ka siguruar abonime aktive në një sërë databazash akademike prestigjioze, përfshirë: SAGE Publications; EBSCOhost; Questia; Edëard Elgar Publishing; ASTM Compass. Studentët kanë akses në këto databaza përmes kredencialeve institucionale dhe udhëzimeve të ofruara nga biblioteka, e cila gjithashtu ofron asistencë për përdorimin efikas të burimeve online.</p> <p>Ky akses garanton përfshirje të plotë, pa pagesë për të gjithë studentët, dhe kontribuon ndjeshëm në realizimin e objektivave akademike dhe kërkimeve shkencore në studimet e tyre.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e institucionit është e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje teknike mbështetëse, të cilat mundësojnë shfrytëzim pa kufizim për të gjithë studentët, në mënyrë të barabartë dhe të pandërprerë gjatë orarit të funksionimit. Këto mjete përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kompjuterë me akses në internet duke pasur edhe akses në bibliotekën online. Referuar Infrastruktura në funksion të programeve të studimit – Rr. “Xhanfize Keko”, fq. 2 (Ref. Nr. 42).</li> <li>• Ambiente të qeta dhe të pajisura teknikisht për studim individual apo në grup, me infrastrukturë që mbështet përdorimin e teknologjisë në funksion të të nxëniet etj.</li> </ul> <p>Këto resurse sigurojnë që çdo student, pavarësisht nga programi i studimit apo viti akademik, të ketë mundësi reale për të përfituar nga burimet digjitale dhe teknologjike të bibliotekës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në</p>	<p>Shërbimi i bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit, përfshirë programin Bachelor në Psikologji. Ky shërbim ofrohet në gjashtë ditë të javës. Orari i bibliotekës për ditët e Hënë-Premte është 9.00-20.00 dhe për ditën e Shtunë është 10.00-17.00.</p>

përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<b>Referuar Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.8, fq.1 (Ref. Nr. 45.1)</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Biblioteka dhe njësia përgjegjëse e programit raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online, sallat e leximit, përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online etj.  <b>Referuar Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.8, fq.1 (Ref. Nr. 45.1)</b>			
<b>Konkluzione</b>	<i>Në bazë të kriterëve të mësipërme ky program studimi përmban literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjedise mbështetëse në mbështetje të të nxëniet si bibliotekë por edhe mjedise të posaçme. Pavarësisht pasurimit me literaturë të huaj, sugjerohet shtimi i burimeve në gjuhën shqipe, veçanërisht për një program me fokus në shëndetin mendor dhe përgatitjen profesionale në kontekstin shqiptar. Pasurimi i saj është një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
-----------------	------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Regjistrimit të Studentëve dhe Sekretaria Mësimore në UET mbajnë të dhëna për studentët që nga regjistrimi në universitet, arrijtjet akademike, lëshimin e diplomave. Të dhënat e studentëve, përveçse në regjistër, regjistrohen dhe në Sistemin e Menaxhimit të Universitetit (UMIS). Të dhënat personale plotësohen dhe përditësohen edhe në version elektronik. <i>Referuar Dokumenti E-IV Mbi funksionimin e bibliotekës, E.IV.2.8, fq.1 (Ref. Nr. 45.1).</i> Ky sistem ashtu sic është përmendur më lart, përdoret për Regjistrimin dhe menaxhimin e të dhënave personale dhe akademike të studentëve; Monitorimin e progresit akademik, përmes evidencës së lëndëve të ndjekura, notave, provimeve të dhëna dhe krediteve të fituara. Parimi i ruajtjes së të dhënave bazohet në konfidencialitet, siguri dhe integritet. <i>Referuar Statuti i UET, Neni 53, fq.1-2 (Ref. Nr. 2); A.II. Kodi i Etikës, pika A.II.7, nënpika A.II.7.7 fq.3 (Ref. Nr.16)</i></p> <p>Gjithashtu përpara diplomimit, verifikohet saktësia e të dhënave në sistem. <i>Referuar Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, pika E.I.7.4, E.I.7.9 fq.4 (Ref. Nr. 9)</i></p> <p>Gjithashtu, nëpërmjet sistemit LMS, studentët informohen lidhur me procesin mësimor si: Orari, lëndët që frekuenton, komunikimi në kohë reale duke shpërndarë njoftimet, materialet mësimore dhe informacione të tjera.</p> <p>Pedagogu i brendshëm ose i jashtëm i kontraktuar rishtas është i detyruar të ndjekë trajnimin metodologjik, të përvetësorë dokumentet UET, të përvetësorë njohuritë për sistemin LMS nëpërmjet trajnimeve dhe manualit të përdorimit. <i>Referuar Manuali i përdoruesit të sistemit UMS (Ref. Nr. 46)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Në çdo zyrë të stafit akademik dhe administrativ, në kompjuterat përkatës gjendet databaza e Institucionit me emërtimin "Dokumenta UET", ku secili anëtar i institucionit mund të aksesojë në kohë reale të dhëna lidhur me strategjitë, rregulloret, urdhërat administrativ, standartet si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër lidhur me aktivitetin e personelit akademik, ndihmës akademik dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Gjithashtu, zyra e Burimeve Njerëzore administron në mënyrë të sigurt informacionin lidhur me personelin akademik sa i përket titujve shkencorë, ngarkesës mësimore, publikimeve etj.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ofron akses të dedikuar dhe informacion lidhur me çdo hap të procesit mësimor. Personeli akademik ka akses në databazën e Institucionit në “Dokumenta UET” referuar <i>Dokumenti G. Rregullore për burimet njerëzore, pika G.I.10.4, fq.3 (Ref. Nr. 11)</i> ndërsa studentët kanë akses mbi informacionin e programit të studimit për lëndët përkatëse në të cilat regjistrohen në platformën UET LMS. Referuar <i>Guidë për studentët (Ref. Nr. 46.3)</i> Të dhënat personale të studentëve regjistrohen dhe ruhen në sistemin elektronik të menaxhimit të universitetit (UMS).</p> <p><i>Referuar Statuti i UET, Neni 53, pika 53.5, fq.31 (Ref. Nr. 2)</i>  <i>Referuar nr.46. Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët mund të komunikojnë virtualisht nëpërmjet platformës së posaçme UET LMS, Microsoft TEAMS por gjithashtu edhe nëpërmjet email-it. Në secilin rast, studentëve u vihet në dispozicion çdo lloj material lidhur me lëndët e programit të studimit dhe çdo informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve akademike. Për njohjen dhe aftësimin në përdorimin e platformës UET LMS, vijnë në ndihmë guidat përkatëse të hartuara nga Zyra e IT-së: <i>guidë për pedagogun dhe guidë për studentët. Referuar Guidë për pedagogun (Ref. Nr. 46.2); Guidë për studentët (Ref. Nr. 46.3)</i></p> <p>Edhe për përdorimin e platformës Microsoft TEAMS, institucioni ofron trajnim, i cili shërben dhe përdoret për komunikimin dhe mësimin interaktiv online, për të zhvilluar takimet e klubeve studentore dhe aktivitete me të ftuar të ndryshëm etj. <i>Referuar Kalendari i aktiviteteve 2023-2024 (Ref. Nr. 55.1)</i>. Për të aksesuar platformat, pedagogu dhe studentët pajisen me kredencialet përkatëse.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Vënia në funksion dhe përdorimi i sistemeve të analizuar në kriteret e mësipërme, garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, duke mundësuar raportimin dhe të dhënat për organet drejtuese dhe titullarët.</p> <p>Sistemet me të cilat UET funksionon, ofron të dhëna në kohë reale mi ecurinë e procesit mësimor, angazhimin e personelit akademik, ndjekjen e programeve nga studentët etj.</p> <p>Në kuadër të analizës së cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimit ndaj studentëve në UET, analizohet aktivizimi i</p>

	<p>çdo pedagogu dhe student në platformën interaktive UET LMS (Learning Management System). Përdorimi i sistemeve bën të mundur që të hartohen raporte të personalizuar, që mund të gjenerohen për secilin individ, njësi akademike apo administrative, duke përfshirë analiza mbi ngarkesat mësimore, aktivitetet kërkimore etj (LMS). Nëpërmjet këtyre raporteve iu ofrohet akses autoriteteve drejtuese dhe organeve vendimmarrëse, të cilët kanë mundësi të marrin vendime të bazuara në të dhëna konkrete, të strukturuar dhe të verifikueshme. Këto të dhëna ndihmojnë gjithashtu edhe për procesin e planifikimit dhe sigurimit të cilësisë, përmes pasqyrimit të menjëhershëm të devijimeve apo nevojave për ndërhyrje. Ky sistem përforcon transparencën, efikasitetin dhe llogaridhënien në të gjitha nivelet e funksionimit të institucionit, duke qenë një mjet thelbësor për drejtim strategjik dhe operacional.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>UET siguron transparencë dhe akses publik në informacionet që lidhen me veprimtarinë e tij akademike dhe administrative, përmes publikimit të tyre në faqen zyrtare të internetit, në dy gjuhë, ku njëra është gjuha shqipe dhe tjetra gjuha angleze. Në faqen e internetit publikohen rregullisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të dhëna të detajuara për programet e studimit, përfshirë kurrikulat dhe kriteret e pranimit;</li> <li>• Profili i personelit akademik sipas fakulteteve dhe departamenteve, duke përfshirë titujt shkencorë, fushat e ekspertizës, përvojën dhe aktivitetin kërkimor;</li> <li>• Aktivitete akademike dhe studentore, si konferenca, seminare, mobilitete, konkurse dhe projekte të zhvillimit institucional;</li> <li>• Dokumente zyrtare dhe materiale informuese, që ndihmojnë studentët dhe publikun e gjerë për të kuptuar funksionimin dhe standardet e institucionit.</li> </ul> <p>Përmes këtij publikimi dygjuhësh, institucioni garanton qasje të gjerë për studentët vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe për të gjithë aktorët e interesuar në arsimin e lartë, duke përmbytur detyrimin për komunikim të hapur dhe të standardizuar. <i>Referuar Faqja zyrtare e Universitetit European të Tiranës <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> (Ref. Nr. 47)</i></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standart përmbushet plotësisht sepse Institucioni i Arsimit të Lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktiviteteveve akademike, financiare dhe administrative për programin e studimit.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### **Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Në bazë të buxhetimit financiar të miratuar çdo vit, përcaktohet çdo muaj një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve, duke saktësuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> <p>Burim kryesor financimi për programin janë tarifat e ndryshme të shkollimit, kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme me donatorë të huaj ku UET është pjesëmarrës etj. Nga ana tjetër janë kostot e lidhura me programin si p.sh.: shpenzimet e personelit akademik, kostot për student, mirëmbajtja e mjediseve etj.</p> <p><i>Referuar Të dhëna mbi koston për student (Aneks Tabela 18.1) (Ref. Nr. 49)</i></p> <p>Institucioni bën një auditim të përvitshëm të situatës financiare të tij. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin në lidhje me koston për secilin program studimi. Për të kontrolluar ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve, mban të dhëna krahasuese edhe për vitet e kaluara duke bërë të mundur evidentimin e elementeve kryesore që ndikojnë në performancën e qëndrueshme dhe rezultative të institucionit.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve,	Institucioni respekton standardet e hartimit të planit financiar dhe raportimit financiar. Plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson standardet e kërkuara. <i>Referuar Të ardhura dhe financime të ndryshme (Aneks Tabela 18.2) (Ref. Nr. 50)</i> . Pasqyrat financiare përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UET i nënshtrohet procesit të auditimit çdo vit. UET. shpk përmbush kushtet për kryerjen e një ekspertize, prandaj çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare, audituesi ligjor i pavarur jep opinionin në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. <i>Referuar Pasqyrat Financiare 2022 (Ref. Nr. 50.1); Pasqyrat Financiare 2023 (Ref. Nr. 50.2)</i></p> <p>UET pas mbylljes e pasqyrave financiare kryen auditimin e jashtëm nga audituesi ligjor. Raporti i auditimit merr për bazë të gjitha informacionet dhe materialet e nevojshme në lidhje me situatën dhe performancën financiare të institucionit. Raporti i auditimit përmban analizën e zërave të pasqyrave financiare, si edhe opinionin në lidhje me përgatitjen e pasqyrave financiare në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet kombëtare të kontabilitetit.</p> <p>Ky raport ndihmon në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë në programin e studimit. <i>Referuar Raport auditimi viti 2022 (Ref. Nr. 50.3); Raport auditimi viti 2023 (Ref. Nr. 50.4)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e</p>	<p>Institucioni paraqet çdo fillim viti gjendjen financiare të institucionit për programin e studimit pranë njësisë</p>




buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	përgjegjëse. <i>Referuar Statuti UET, Kreu I, Neni 10, pika 10.7, fq. 6 (Ref. Nr. 2)</i>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Buxhetimi financiar hartohet në muajin Tetor të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri/ët e institucionit. Për zbatim të këtij buxhetimi, ngarkohet Administratori dhe Zyra e Financës. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku çdo muaj përcaktohet një raport i drejtë i të ardhurave dhe shpenzimeve. Institucioni dëshmon se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p> <p>Analizat sistematike të efikasitetit dhe kostove financiare referuar <i>Pasqyrat Financiare 2022 (Ref. Nr. 50.1); Pasqyrat Financiare 2023 (Ref. Nr. 50.2)</i> sikurse dhe auditimet e brendshme dhe të jashtme referuar raport auditimi viti 2022 (Ref. Nr. 50.3) dhe raport auditimi viti 2023 (Ref. Nr. 50.4) i mundësojnë UET-së marrjen e vendimeve optimale menaxheriale për të siguruar stabilitet dhe vijueshmëri financiare për ofrimin e çdo programi studimi.</p>			
<b>Konkluzionet</b>	<p><i>Plani i financimit të programit të studimit përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase dhe të huaja të përfituara, kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson standardet e kërkuara, IAL respekton standardet e hartimit të planit financiar dhe raportimit financiar.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>
--	----------------	-----------------------	----------------------	-----------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Institucioni ka hartuar dhe vënë në zbatim politika dhe procedura që mbulojnë në mënyrë të plotë ciklin e studimeve universitare, Bachelor në “Psikologji” me profil “Shëndet Mendor”, nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto politika janë përcaktuar në Statutin (<i>Statuti i UET (Ref. Nr.2)</i>) dhe Rregulloren e studimeve universitare përkatëse (<i>Rregullore UET, Kreu 3, Neni 11, pika 1, fq.4 (Ref.Nr.5); Dokumenti D.I. Mbi politikat, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve (Ref. Nr. 27.1)</i>)</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Psikologji” është i organizuar me 180 kredite formimi. Gjuha e zhvillimit të programit është gjuha shqipe. UET ka një strukturë të mirë-organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje, me qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave në mbështetje të ecurisë së studentit gjatë të gjithë ciklit të studimit. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura institucionale.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit</p>	<p>Kriteret dhe procedurat nga hyrja në dalje janë transparente për të gjithë, duke garantuar barazi dhe të drejta të barabarta për kandidatët dhe studentët e programeve të studimit. Në këtë kuadër, UET siguron që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kriteret e pranimit dhe regjistrimit të studentëve të jenë të qarta dhe të barabarta për të gjithë kandidatët, pa diskriminim për arsye të gjinive, grupeve etnike, statusit social-ekonomik, besimeve fetare apo orientimit seksual;</li> <li>• Të drejtat e studentëve të jenë të mbrojtura dhe të garantuara gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke përfshirë të drejtën për informim të plotë, akses të barabartë në burimet akademike dhe administrative, mundësinë e përfaqësimit dhe shprehjes së mendimeve etj;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mekanizmat e ankimit dhe të apelimit të jenë të disponueshme dhe të drejta për të gjithë studentët dhe kandidatët, për të siguruar që çdo vendimmarrje të jetë e bazuar në meritë dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përshkruara;</li> <li>• Mbështetja akademike dhe administrative është e barabartë për të gjithë studentët, duke përfshirë tutoriatin, mbështetje për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje në aktivitete akademike dhe praktika profesionale.</li> </ul> <p>Nëpërmjet këtyre politikave dhe procedurave, institucioni siguron një mjedis akademik që respekton të drejtat e studentëve dhe promovon barazinë dhe mundësitë e barabarta për të gjithë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Studentët mund të gjejnë të gjithë informacionin rreth programit të studimit Bachelor në Psikologji” dhe kriterëve të pranimit që ofrohen tek faqja zyrtare web (Faqja zyrtare e Universitetit Europian të Tiranës <a href="http://www.uet.edu.al">www.uet.edu.al</a> (Ref. Nr. 47). Gjithashtu informacioni i plotë rreth kriterëve, procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit së studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga vetë studentët (<i>Rregullore e UET, Neni 11 fq.4, Neni 38 fq.10, dhe Neni 35 fq. 10 (Ref.Nr.5).</i></p> <p>Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit Bachelor në Psikologji, janë të përcaktuara edhe në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Referuar nr.7: Rregullore mësimore BA Psikologji.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Informacioni i plotë rreth kriterëve, procedurave të pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit së studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga vetë studentët (<i>Rregullore e UET, Neni 11 fq.4, Neni 38 fq.10, dhe Neni 35 fq. 10 (Ref.Nr.5).</i> Këto informacione janë të publikuara në mënyrë të qartë dhe në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme nga aplikantët dhe studentët në faqen zyrtare të internetit të institucionit. Gjithahstu, Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, është në dispozicion të studentëve për të dhënë informacione lidhur me kriteret, procedurat e transferimeve dhe pranimit të studentëve.</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit, si psh. Nota mesatare, testimet institucionale etj., nëpërmjet informacionit në ëbsite-n e tij, pritjes dhe informimit nga këshilluesit e karrierës, komunikimit me zyrën e pranimeve, takimeve me studentët potencialë. Etj (Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin (Ref.Nr.28); Dokumenti E.VII. Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit. (Ref.Nr.12); Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik (Ref.Nr.27.2).</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni i publikon kriteret pranimit të studentëve në faqen zyrtare web (Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, pika D.II. 7.5 (Ref.Nr.28) çdo vit akademik, në përputhje me politikat institucionale. Gjithë informacioni për kriteret dhe procedurën e aplikimit publikohet online, në broshurën informuese (Guida UET), fushatat informuese mediatike, si edhe gjatë këshillimit në institucione. UET gjithashtu ofron mundësi edhe për mbështetje financiare për studentë që i përkasin grupeve minoritare, grupeve me nevoja të veçanta etj. UET synon dhe kryen përpjekje të vazhdueshme që të krijojë një mjedis të hapur, gjithëpërfshirës dhe të drejtë, ku çdo student ka mundësinë të zhvillohet akademikisht dhe personalisht, pavarësisht prejardhjes apo aftësive individuale.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të pranimit në programin e studimit, janë hartuar dhe zbatohen në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore në fuqi. Regjistrimi i studentëve shqiptarë nga trojet dhe të studentëve të huaj bëhet mbështetur në udhëzimet e MAS dhe çdo vit UET parashikon kuota të veçanta për regjistrimin e shqiptarëve nga trojet. UET-i pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera, sipas procedurave të parashikuara me dokument të veçantë. Studenti duhet të ndjekë në UET, jo më pak se një vit akademik dhe jo më pak se 30% të ECTS-ve teorike, si dhe detyrimet përmbyllëse (kategoria E e programit). Përjashtim nga ky rregull bëjnë studentët e transferuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë, të vendeve të OECD-së, të cilat sipas vlerësimit të KNJ-së, janë të njohura për standarde të</p>

	<p>larta të cilësisë. Në çdo rast studenti duhet të ndjekë në UET, jo më pak se 25% të ECTS-ve teorike, si dhe detyrimet përmbyllëse.</p> <p><b>Dokumenti D.II. Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin, pika D.II. 7.5 ( Ref.Nr.28)</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>UET ofron bursa të plota ose të pjesshme studimi, mbi bazën e disa kriterëve përzgjedhjeje, me synimin për të nxitur rezultate sa më të larta në studime, si dhe për të luajtur një rol të rëndësishëm social, duke u ardhur në ndihmë shtresave të diskriminuara dhe në nevojë. UET-i ofron zbritje të tarifës së shkollimit në rastin e aplikantëve/studentëve me rezultate të larta, ata nga e njëjta familje si dhe harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit <i>(Rregullore e UET, Neni 12 fq.4 (Ref.Nr.5)</i>. Politikat e bursave përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bursa sociale dhe ndihmë financiare për studentët nga shtresat e marginalizuara, familjet me të ardhura të ulëta apo kategori të veçanta që identifikohen nga strukturat përkatëse;</li> <li>• Bursa ekselence që inkurajojnë pranimin dhe qëndrueshmërinë akademike të studentëve me performancë të lartë;</li> <li>• Transparencë në shpalljen e kriterëve dhe përzgjedhjen e përfituesve, përmes publikimeve në faqen zyrtare dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me studentët potencialë.</li> </ul> <p>Këto politika ndihmojnë jo vetëm në rritjen e aksesit në arsim të lartë, por edhe në drejtimin e burimeve njerëzore drejt fushave të rëndësishme për tregun e punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET ka një strukturë të mirë organizuar për shërbimet studentore nga hyrja në dalje, me qëllim hartimin dhe zbatimin e politikave dhe procedurave në mbështetje të ecurisë së studentit gjatë të gjithë ciklit të studimit. Institucioni kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura institucionale. Këto politika ndihmojnë jo vetëm në rritjen e aksesit në arsim të lartë, por edhe në drejtimin e burimeve njerëzore drejt fushave të rëndësishme për tregun e punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e programit të studimit janë parashikuar procedurat dhe informacion lidhur me procesin dhe të gjithë përparimin akademik. Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e studentëve, dokumentimi i vlerësimeve, zhvillimi i provimeve, e drejta për të hyrë në provim, kritere dhe procedura të vlerësimit etj. <i>(Rregullore mësimore e programit të studimit Bachelor në Psikologji, Neni 5, faqe3, (Ref.Nr.7)</i> Njëkohësisht nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, institucioni vihen në dispozicion dhe ofrohen informacion i plotë dhe i hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. UET-i, në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës (Rregullore UET, Neni 13, pika 1, fq.4 (Ref.Nr.5), pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera universitare, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera. Procedura e transferimit nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi janë të përcaktuara në Dokumenti D.II "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" <i>Dokumenti D.II. "Mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin" (Ref.Nr.28); Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref.Nr.12); Dokumenti A.V. Mbi tutoriatin dhe këshillimin akademik (Ref.Nr.27.2).</i>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit shprehet qartë mënyra e vlerësimit të dijeve në lëndët përkatëse në përputhje me tipologjinë e tyre. Njëkohësisht studenti e merr këtë informacion edhe në syllabusin e lëndës që në javën e parë të mësimin, peshën e komponentëve të vlerësimit në notën përfundimtare ( <i>Syllabuset e lëndëve të ofruara në programin e Bachelor në Psikologji Ref.Nr. 19</i> )

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@asca.al

	<p>. Ata marrin informacion për kriteret e përmirësimit të notës, mundësit për riprovim afatet për ankimin etj. Këto informacione studentët mund t'i marrin gjatë javës së orientimit, gjatë takimeve me drejtuesit e departamenteve, me stafin akademik që realizojnë procesin e tutoriatit, e-maileve nga Sekretari i përgjithshëm etj. Pra, si konkluzion mund të parashatrojmë se institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studenteve në programin e studimit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Dokumenti për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri te formatimi konkret i punimit, dorëzimit dhe mbrojtjen. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu studentët njoftohen nëpërmjet e-mailit për çdo veprimtari akademike, nga koordinatoret e Departamenteve. Në Rregulloren e Programit të Studimit dhe në Dokumenta UET, janë të përcaktara qartë kushtet dhe kriteret në rastin që studentët mund të kryejnë një punim diplome, apo të diplomohen nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Çdo pranverë UET-i organizon grupe pune të përbëra nga pedagogë dhe studentë, të cilët vizitojnë shkolla të mesme në qytete të ndryshme të vendit (<i>Gjinnaz tour</i>) për t'iu bërë të njohur maturantëve programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'iu ndihmuar ata të bëjnë një zgjedhje të mirinformuar dhe të ndërgjegjshme (<i>Dokumenti D.I. Mbi politikën, kriteret dhe procesin e pranimit të studentëve D.I.1.1(Ref. Nr. 27.1)</i>) Gjithashtu UET zhvillon Open Days ku maturantët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi, si edhe Javën e Orientimit për studentët e rinj, përpara fillimit të vitit akademik. Përgjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të maturantëve të interesuar për të vazhduar studimet e larta, grupe pedagogësh sipas fakulteteve. Ata japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UET. Mbledhjet e hapura të departamenteve shërbejnë gjithashtu për informimin dhe diskutimin me studentët lidhur me programet e studimit.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Nëpërmjet zyrës së pranimeve, zyrës së këshillimit të karrierës dhe sekretarisë, institucioni vë në dispozicion dhe ofron informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

	<i>studentëve dhe shtyrjes së studimeve në një vit tjetër akademik. Edhe ky standart përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Një informacion i detajuar mbi strukturën e programit, kohëzgjatjen e programit të studimit jepet në rregulloren e programit të studimit Bachelor në Psikologji” (<i>Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në Psikologji</i>)” (Ref. Nr. 7). Kjo rregullore publikohet në fillim të çdo viti akademik. Që në momentin e aplikimit, regjistrimit, por edhe në vazhdim, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit Bachelor në Psikologji” nga Zyra e Pranimeve, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe pedagogëve (<i>Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, E.VII.1- E. VII.4, fq. 86,(Ref.Nr. 12); Rregullore e UET, Neni 36, 37 (Ref.Nr.5)</i>)</p> <p>Ky informacion gjendet i publikuar edhe në faqen zyrtare të UET, UET LMS, ku çdo student ka akses (<i>UET LMS Guide për studentët, (Ref. Nr. 46.3)</i>).</p> <p>Gjithashtu UET zhvillon “Javën e Orientimit” për studentët e rinj, përpara fillimit të vitit akademik. <i>Rregullore e UET, Kreu 8, Neni 36 – 37, fq.10 (Ref. Nr.5)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Studentët e programit të studimit Bachelor në Psikologji që në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë studimit të tyre marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve përkatës. Në fillim të çdo semestri atyre u vihet në dispozicion nga pedagogu i lëndës dhe programi lëndor (syllabuset), në të cilin janë specifikuar temat për çdo javë mësimore, shoqëruar me literaturën e detajuar me faqe, por edhe format e vlerësimit të dijeve. Këto informacione dhe dokumenta merren dhe gjenden në zyrën e dhe koordinatorëve, në UET LMS (<i>UET LMS Guide për studentët, (Ref.Nr. 46.3)</i>) dhe të dhëna mbi programin e studimit gjenden në website-n e institucionit.</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, nëpërmjet:  Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, e cila e zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me këshilluesit e karrierës së çdo fakulteti/departamenti, si dhe duke u diferencuar në funksion të nivelit të studimit (<i>Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12).</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bordeve të tregut të punës – të cilat shërbejnë si urë lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës</li> </ul> <p>Organizimit të panairëve të punës dhe aktivitete me aktorë nga tregu i punës (<i>Bordi i Tregut të Punës (Ref. Nr. 12.1)</i>)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dërgimit të njoftimeve tek studentët mbi mundësitë e ndryshme për punësim.</li> <li>• Praktikave Profesionale të detyrueshme.</li> </ul> <p>Përmes kësaj qasjeje të organizuar, institucioni rrit punësimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për t'u përshtatur me kërkesat dinamike të tregut të punës, duke u ofruar udhëzimin dhe mjetet e nevojshme për një tranzicion të suksesshëm nga studimet në karrierë.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë, i qartë dhe i përditësuar në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, si dhe për logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse që garantojnë realizimin cilësor të tij, nga strukturat e UET. Ky informacion përfshin disa burime si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Orarin e mësimit, kalendarin akademik dhe ndarjen e moduleve sipas semestrave, të cilat publikohen përpara fillimit të çdo semestri;</li> <li>• Vendndodhjen e ambienteve mësimore, klasave, laboratorëve dhe mjediseve të tjera të nevojshme për zhvillimin e mësimit teorik dhe praktik;</li> <li>• Mjetet dhe platformat teknologjike në dispozicion të studentëve, si LMS për ndjekjen e leksioneve, dorëzimin e detyrave dhe komunikimin me stafin akademik;</li> <li>• Shërbimet mbështetëse si biblioteka, zyra e IT-së, zyra e studentëve dhe mbështetja për studentë me nevoja të veçanta;</li> <li>• Njoftime dhe informacione të vazhdueshme, të shpërndara përmes kanaleve zyrtare të komunikimit (email institucional, LMS, ëesite zyrtar, njoftime fizike në mjediset e institucionit).</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tutoriati dhe këshillimi akademik</li> </ul> <p>Përmes kësaj qasjeje, institucioni siguron transparencë, orientim dhe përfshirje të studentëve, duke i mundësuar atyre të planifikojnë, ndjekin dhe përfitojnë maksimalisht nga përvoja e tyre akademike.</p>			
<b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	I gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes ëbsite të UET, si dhe LMS. Studenti zotëron një account personal në LMS për të marrë një sërë shërbimesh. Ky sistem i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë. Kjo mundëson një pavarësi dhe lehtësi në marrjen e shërbimeve si edhe mundësi për më shumë transparencë.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky standart përmbushet plotësisht pasi studentët e programit të studimit Bachelor në Psikologji që në fillim të vitit akademik, por edhe gjatë studimit të tyre marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me modulet, lëndët dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit nëpërmjet koordinatorit të departamentit dhe pedagogëve përkatës. I gjithë informacioni në lidhje me procesin mësimor bëhet lehtësisht i aksesueshëm përmes ëbsite të UET, si dhe LMS. Studenti zotëron një account personal në LMS për të marrë një sërë shërbimesh. Ky sistem i mundëson studentit të marrë informacion të nevojshëm edhe në distancë. Kjo mundëson një pavarësi dhe lehtësi në marrjen e shërbimeve si edhe mundësi për më shumë transparencë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimit deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë dhe totalin e studentëve aktivë në program; numrin e studentëve që përfundojnë studimet në kohë ose me vonesë; shkallën e diplomimit në raport me numrin e regjistrimeve; përqindjen sipas gjinive, moshës apo statusit të veçantë (p.sh. studentë të huaj, etj.) punësimin gjatë dhe

	<p>pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi. Nëpërmjet Zyrës së zhvillimit të karrierës dhe Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mbahen kontakte të vazhdueshme me ish-studentë me qëllim jo vetëm ndarjen e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit dhe tregut të punës. Këto të dhëna shërbejnë si bazë për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Monitorimin e trendeve të regjistrimeve dhe përfundimeve të studimeve;</li> <li>• Vlerësimin e performancës së programeve të studimit dhe përshtatshmërinë e tyre me kërkesat e tregut;</li> <li>• Raportimin institucional, në kuadër të vetëvlerësimit, akreditimit dhe kërkesave nga autoritetet përkatëse (MAS, ASCAL, INSTAT etj.).</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UET mbledh dhe administron statistika vjetore të detajuara për ciklin e plotë të ndjekjes së studentëve në programin e studimit, duke filluar nga regjistrimi deri në diplomim për programin e studimit Bachelor në Psikologji</p> <p>Këto statistika përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrin e studentëve të regjistruar në fillim të çdo viti akademik, për secilin program studimit, por edhe zgjedhjet e lëndëve që behen në cdo fillim semestri;</li> <li>• Numrin e studentëve që përfundojnë studimet në afat, si dhe ata që përfundojnë me vonesë;</li> <li>• Numrin dhe përqindjen e tërheqjeve nga programi, me ose pa arsye të justifikuara (transferime, ndërprerje për arsye personale,);</li> <li>• Rastet e largimit nga programi para përfundimit të tij apo mospërfundimit me sukses të vitit akademik (p.sh. për shkak të mosplotësimit të kriterëve akademike).</li> </ul> <p>Të dhënat regjistrohen dhe përpunohen nga njësitë përgjegjëse si Zyra e Regjistrimit, Sekretaria mësimore dhe zyra e Kujdesit ndaj Studentit, dhe janë të aksesueshme për strukturat akademike, Dekanit Drejtuesit</p>




	<p>e departamenteve, për vlerësimin e performancës së programit dhe për hartimin e masave për përmirësimin e mbajtjes së studentëve dhe reduktimin e drop-out. Përmes analizës së rregullt të këtyre statistikave, institucioni synon të identifikojë faktorët që ndikojnë në vazhdimësinë apo ndërprerjen e studimeve, si dhe të ofrojë mbështetje të synuar për kategoritë në rrezik të drop-out.</p> <p><i>Në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në "Psikologji" me profil "Shëndet Mendor, për vitin akademik 2021-2022 janë të regjistruar 18 studentë, 2022-2023 janë regjistruar 18 studentë, për vitin akademik 2023-2024 22 studentë, dhe për vitin akademik 2024-2025 në 33 studentë .</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve programin Bachelor në Psikologji" që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre duke mbajtur në sistem të dhëna për prezencën, vlerësimin dhe stadin ku ndodhet një student, lidhur me programin që ndjek. <i>Referuar Dokumenti E.I Mbi funksionimin e sekretarisë mësimore, E.I.5.1 – 5.14, fq.70 - 71 (Ref. Nr. 9).</i> Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një program informatik i cili është krijuar për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të Universitetit, si: financat studentore, aktivitetin e Bibliotekës, etj. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga personi pranë Zyrës IT-së me detyrë funksionale menaxhimin teknik të sistemit UMIS. Në lidhje me punësimin është Zyra për Zhvillimin e Karrierës dhe Shoqata Alumni, që ndjekin studentët.</p> <p><i>Referuar (nr.12): Dokumenti E.VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit.pdf</i>  <i>Referuar (nr.46): Manuali i përdoruesit të sistemit UMIS.pdf</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë</p>	<p>Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Këto të dhëna gjenden në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Regjistrimit të Studentëve. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) administron dhe përpunon të gjitha të dhënat e studentit, atyre akademike</p>




<p>mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>si dhe prodhimin e raporteve statistikore. KSBC në planin e veprimit të saj midis të tjerave, parashikon monitorime të vlerësimit të studentëve dhe procesit të hedhjes së notave, plotësimit dhe administrimit të dokumentacionit në sekretarinë mësimore.</p> <p><b>Referuar Plani i veprimit të KSBC (Ref. Nr.30.1)</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Në UET hartohen raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe punësimin e tyre, duke i reflektuar këto të dhëna me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontaktet me studentët e diplomuar nëpërmjet strukturës së UET Alumni dhe harton raporte periodike mbi cilësinë në dalje dhe shkallën e punësimit të studentëve. Raportet shoqërohen me analiza krahasuese ndër vite dhe masa konkrete për përmirësimin e treguesve, duke përfshirë rishikimin e programeve, forcimin e bashkëpunimit me tregun e punës dhe mbështetjen individuale për studentët në hyrje dhe dalje.</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë dhe totalin e studentëve aktivë në program; numrin e studentëve që përfundojnë studimet në kohë ose me vonësë; shkallën e diplomimit në raport me numrin e regjistrimeve; përqindjen sipas gjinive, moshës apo statusit të veçantë (p.sh. studentë të huaj, etj.) punësimin gjatë dhe pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi. Edhe ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi V.5**


**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe</p>	<p>Studentët përfaqësohen në organet drejtuese të institucionit, në strukturat mësimore-kërkimore dhe të shërbimeve. UET-i inkurajon pjesëmarrjen e studentëve</p>




<p>angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>në vendimmarrje, organizimin e lirë, dhe shprehjen e mendimit të tyre (<i>Statuti UET, Neni 16, 19 dhe 51 (Ref. Nr. 2)</i>)  Ndër strukturat kryesore përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Këshilli i Studentëve - realizon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese.</li> <li>• Senati Akademik –ka përfaqësues të studentëve.</li> <li>• Këshilli Etikës - një anëtar i rekomandohet Rektorit nga Këshilli i Studentëve.</li> <li>• KSBC – ka një anëtar përfaqësues nga Këshilli i Studentëve.</li> </ul> <p>Mbledhjet e departamenteve, një herë në muaj është e hapur për studentët.  <b>Referuar (nr.2): Statuti i UET.pdf</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>UET garanton përfshirje reale, të strukturuar dhe me ndikim konkret të studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në proceset vendimmarrëse, këshilluese dhe ato të vlerësimit të komponentëve akademikë dhe institucionalë, në strukturat e përmendura edhe në kriterin e mësipërm.</p> <p>Përfshirja e tyre është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Reale</i>, pasi përfaqësuesit studentorë janë pjesë aktive në organet ku diskutohen dhe merren vendime që lidhen drejtpërdrejt me jetën akademike, si Senati Akademik, KSBC, etj.;</li> <li>• <i>Konkrete</i>, duke kontribuar me sugjerime, vlerësime dhe rekomandime të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve përkatëse me Rektorin në fund të çdo muaji ose në mbledhjet e hapura me departamentin;</li> <li>• <i>Frutdhënëse</i>, sepse propozimet e studentëve janë reflektuar në vendimmarrje të rëndësishme, si përmirësime në orare, infrastrukturë, mënyra vlerësimi apo mbështetje për praktika dhe mobilitete etj;</li> <li>• <i>E matshme dhe e verifikueshme</i>, pasi institucioni dokumenton pjesëmarrjen, ndikimin dhe rezultatet që kanë ardhur si rrjedhojë e përfshirjes së studentëve në një proces të caktuar.</li> </ul> <p>Kjo përfshirje është e rregulluar me akte të brendshme dhe udhëzime specifike, të cilat sigurojnë që zëri i studentëve të jetë jo vetëm i dëgjuar, por edhe i përfshirë në mënyrë të</p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>sistematizuar në zhvillimin e institucionit dhe programeve të tij të studimit.</p> <p>Departamenti i Psikologjisë, Edukimit dhe Sporteve garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit në mënyrë të rregullt. Kjo përfshirje realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mbledhjeve të hapura, ku studentët mund të japin sugjerime dhe opinione mbi përmbajtjen dhe organizimin e programit të studimit;</li> <li>• Përdorimit të pyetësorëve të vlerësimit online dhe fokus grupeve, për të mbledhur mendime dhe sugjerime të studentëve në lidhje me aspekte të ndryshme të programit, si metodologjitë e mësimdhënies, cilësia e mësimdhënies nga personeli akademik, literatura, mundësitë e praktikave profesionale etj;</li> <li>• Analizës dhe reflektimit të sugjerimeve dhe kontributeve të studentëve në përmirësimin e strukturës dhe përmbajtjes së moduleve të studimit.</li> </ul> <p>Ky proces siguron që kontributi i studentëve të jetë i vlefshëm dhe i dokumentuar dhe se ndryshimet e mundshme të bëhen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e studentëve dhe me standardet akademike të institucionit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e pedagogut përgjegjës. Provimet janë të sekretuara dhe garantohej totalisht anonimiteti i studentit. Vlerësimet e rubrikave të tjera janë gjithashtu transparente dhe pas çdo vlerësimi studentët vihen në dijeni për pikët e tyre. Pas çdo provimi organizohen dhe kryhen seancat sqaruese në të cilat studentët kuptojnë dhe komunikojnë me pedagogun përkatës lidhur me vlerësimin dhe mundësinë për rishikim të vlerësimit Referuar Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Psikologji Pika 5.8, faqe 5, (Ref. Nr. 7); Rregullore UET, Neni 27, pika 27.8; Neni 28, pika 28.4, 28.5, faqe 8, (Ref. Nr. 5). Në rast ankimimi, përsëri procedurat janë transparente dhe vlerësimi bëhet përmes një komisioni AD-HOC që ngrihet në nivel departamenti/fakulteti.</p> <p><b>Referuar Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Psikologji, Pika 5.8.2, faqe 5, (Ref. Nr. 7)</b></p>




<b>Konkluzione</b>	<i>Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me cilësinë në hyrje dhe dalje, numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë dhe totalin e studentëve aktivë në program; numrin e studentëve që përfundojnë studimet në kohë ose me vonësë; shkallën e diplomimit në raport me numrin e regjistrimeve; përqindjen sipas gjinive, moshës apo statusit të veçantë (p.sh. studentë të huaj, etj.) punësimit gjatë dhe pas diplomimit, etj. Të dhënat janë të detajuara dhe në bazë të profileve për secilin program studimi. Edhe ky standart përmbushet plotësisht.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Njësia e posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në UET është zyra e Kujdesit ndaj Studentit. (Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12) Referuar Dokumenti E-VII Mbi funksionimin e Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit (Ref. Nr. 12).</p> <p>Kjo zyrë ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Tutoriati dhe këshillimi akademik, sikurse dhe këshilluesit e karrierës në çdo Departament janë gjithashtu në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Sekretaria mësimore dhe koordinatorët e departamentit, të cilat menaxhojnë dokumentacionin akademik të studentëve dhe japin informacion mbi regjistrimin, oraret, provimet, rezultatet dhe diplomimin. Gjithashtu, platforma online LMS, siguron akses 24/7 në njoftime, materiale akademike dhe komunikim me stafin.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin,	UET ka një sistem të posaçëm për studentët për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin ndaj tyre. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, Këshilluesit

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

<p>ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Akademik, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve, pedagogët e tutoriatit, etj mbështesin studentët për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit dhe jo vetëm. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit ndaj studentëve, si edhe njësive të tjera, por edhe me anë të sistemit UET LMS ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. UET gjithashtu, trajnon në mënyrë të vazhdueshme stafin akademik sic është “Tutoring the Relaunch”, për t’i ofruar studentëve mundësinë për komunikim të hapur dhe ndihmon në identifikimin e hershëm të vështirësive akademike, duke ndërmarrë masa parandaluese dhe mbështetëse për të rritur suksesin e studentëve në përfundimin e programit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Studentët kanë shërbim të vazhdueshëm të këshillimit të karrierës. Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve. <i>Referuar Dokumenti B.I. Mbi praktikën profesionale, pika B.I.3.2 (Ref.Nr.32.1)</i>, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata. Çdo department, ka një pedagog të cilit i është caktuar roli i Këshilluesit të Karrierës, i cili u jep njohuri të përgjithshme të zhvillimit profesional dhe karrierës studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Zyra e Këshillimit të Karrierës mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Kjo njësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizon anketime dhe sondazhe periodike me të diplomuarit, për të vlerësuar fushat ku janë punësuar, kohëzgjatjen deri në punësim, dhe përputhshmërinë mes studimeve të ndjekura dhe pozicionit të punës;</li> <li>• Përpunon të dhënat për të ndërtuar statistika të qarta dhe raporte analitike për shkallën e punësimit, llojet e sektorëve ku studentët janë</li> </ul>

	<p>integruar, si dhe sfidat kryesore me të cilat përballen pas përfundimit të studimeve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informon dhe raporton tek autoritetet drejtuese të institucionit, për të ndihmuar në rishikimin dhe përshtatjen e programeve të studimit sipas kërkesave reale të tregut.</li> </ul> <p>Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe Zyra Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të marrë mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në vend e më gjerë.</p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>UET ka një sistem të posaçëm për studentët për informimin, këshillimin, ndjekjen, asistimin ndaj tyre. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj Studentit, Zyra e Projekteve dhe Partneriteteve, Këshilluesit Akademik, sekretaria mësimore, koordinatorët e departamenteve, pedagogët e tutoriatit, etj mbështesin studentët për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit dhe jo vetëm. Kjo bëhet kryesisht nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Kujdesit ndaj studentëve, si edhe njësisive të tjera, por edhe me anë të sistemit UET LMS ku ofrohen informacione të përditësuara për procesin mësimor dhe programin e studimit. UET gjithashtu, trajnon në mënyrë të vazhdueshme stafin akademik dhe kjo tregon përmbushjen plotësisht të këtij standarti.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

### Standardi VI.1

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gimn. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: [www.asc.al](http://www.asc.al)

E-mail: [info@asc.al](mailto:info@asc.al)

Kriteret	Vlerësimi
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni parashikon qartë si prioritet thelbësor trajnimin e personelit akademik për ndryshimin e stilit dhe metodave të mësimdhënies, si një investim dhe domosdoshmëri për zhvillimin e burimeve njerëzore. UET ofron në mënyrë të vazhdueshme trajnime për stafin akademik, lidhur me metodat e mësimdhënies si psh: Metodatat inovative të mësimdhënies; Methodological training etj. Inkurajon përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor duke përdorur projektorët, poëer point, dhe ka kryer trajnime të vazhdueshme edhe për këtë. UET U jep mundësi pedagogëve të zhvillojnë autonomi akademike në zgjedhjen e metodave që përshtaten më mirë me objektivat formues të moduleve. Këto pasqyrohen edhe në silabus, ku pedagogu vendos metodat që do përdoren në seminarin e rradhës si psh: mësimi përmes projekteve, puna në grup, mësimi i ndërsjellë dhe diskutimet e strukturuar; rastet studimore. UET ka miratuar Strategjinë e Student centred Learning, e cila synon të përshtasë procesin e mësimdhënies sipas nevojave dhe rekomandimeve të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik i nënshtrohet në mënyrë periodike trajnimeve, testeve dhe vlerësimeve prej strukturave përgjegjëse në institucion për identifikimin dhe vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. Pra, në këtë mënyrë inkurajohet dhe nxirret në pah dëshira dhe prirja për të sjellë risi e përparim në formën e përcjelljes së dijes drejt studentit.</p> <p>Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vlerësimi i mësimdhënies në auditor, kryesisht për anëtarët e personelit akademik të kategorisë lektorë dhe asistentë lektorë, nga Dekani, Përgjegjësi i Departamentit ose përgjegjësit të grup-lëndës Referuar Formulari i vlerësimit të pedagogut nga eprori-kolegu (Ref.Nr.30.16)</li> <li>- vlerësimi i pedagogut dhe lëndës nga studentët që kryhet në fund të çdo semestri, duke ruajtur anonimatit e tyre, vlerësimi përmes fokus grupeve me studentët, si dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>- rezultatet e raporteve të KSBC-së; e cila është drejtpërdrejtë përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. KSBC zhvillon aktivitetin bazuar në planin e veprimit për sigurimin e cilësisë dhe metodologjitë përkatëse të punës për çdo aktivitet. Aktivitetet kryhen në mënyrë periodike dhe KSBC harton relacionet përkatëse, të cilat i dërgohen Rektoratit dhe/ose Departamenteve përkatëse;</li> <li>- vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori (folloë-up) . referuar Formulari i vetëvlerësimit të performancës së personelit akademik (<i>Ref.Nr.41</i>)</li> </ul> <p>Të dhënat e mbledhura nga këto mekanizma shërbejnë për hartimin e rekomandimeve konkrete, për përshtatjen e metodave të përdorura me objektivat formues të programeve, dhe për mbështetjen në mënyrë të qëndrueshme të zhvillimit profesional të stafit akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>UET garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies, duke u dhënë atyre të drejtën për të vlerësuar pedagogun dhe cilësinë e orës së mësimin, nëpërmjet vlerësimit me formular/pyetësor anonim nga studenti, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si dhe secilit pedagog në mënyrë të personalizuar. <i>Referuar Formati i vlerësimit të pedagogut nga studentët online (Ref.Nr. 40)</i></p> <p>Studentëve u jepet mundësia e trajtimit të ankimeve, nëpërmjet mbledhjeve mujore të përbashkëta me stafin akademik, në të cilat diskutohen rreth problematikave që mund të kenë hasur gjatë ecurisë së procesit mësimor.</p> <p>Për sa i përket vlerësimit individual të studentëve, fillimisht kryhen seanca sqaruese brenda 2 javëve nga data e zhvillimit të provimit, dhe vetëm në rast pakënaqësie në përfundim të këtyre seancave, studenti i drejtohet Drejtuesit të Departamentit për rivlerësim, mbështetur në nenin 32 të Rregullores së UET. Të gjitha vlerësimet dhe ankesat e studentëve trajtohen në mënyrë të strukturuar, duke siguruar përgjigje zyrtare dhe masa për përmirësim, kur është e nevojshme. Përfshirja e studentëve në këto procese garanton një qasje të transparente,</p>

	gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme ndaj cilësisë së arsimit.
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Përfshirja e strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie në mënyrë periodike, në fund të çdo semestri sjell që rezultatet e vlerësimit të përfuara të bëhen publike.</p> <p>Një nga format e vlerësimit periodik të metodave të mësimdhënies dhe dijeve është nëpërmjet vlerësimit të pedagogut nga student. Në përfundim të secilit monitorim hartohet një raport individual dhe një i përgjithshëm për secilin pedagog ku ai vihet në dijeni për rezultatin e marrë nga vlerësimi i studentëve. Departamenti analizon rezultatet, verifikon besueshmërinë e tyre, dhe merr masa për përmirësimet e nevojshme. Rezultatet e vlerësimit, pasi përpunohen nga KSBC, referuar <i>Dokumenti F.VII Mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Ref. Nr. 8)</i> apo zyra e IT në rastin e vlerësimeve online, i komunikohen autoriteteve drejtuese të UET, si edhe anëtarëve të personelit akademik nga Drejtuesi i Departamentit. Kjo transparencë në publikimin e të dhënave ndihmon për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe forcon besimin e studentëve në procesin arsimor.</p>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Strategjia e ndjekur për monitorimin e vlerësimit dhe rezultateve të marra nga institucioni, nëpërmjet mekanizmave të tij specifik, promovon shembuj të praktikave të mira, frytdhënëse, të cilat nxitin dhe inkurajojnë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Të gjitha rezultatet e gjeneruara nga format e ndryshme të monitorimit lidhur me vlerësimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies diskutohen në mbledhjet e departamentit duke u promovuar shembujt pozitiv dhe duke nxitur përmirësimin e mëtejshëm në mësimdhënie.</p>
<b>Konkluzione</b>	<i>Duke konstatuar në të gjitha fushat mësipër, gjv del në përfundimin që përmbushet plotësisht dhe kjo evidentohet në metodat inovative të mësimdhënies; methodological training etj. Institucioni Inkurajon përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor duke përdorur projektorët, poëer point, dhe ka kryer trajnime të vazhdueshme edhe për këtë. UET u jep mundësi pedagogëve të zhvillojnë autonomi akademike në zgjedhjen e metodave që përshtaten më mirë me objektivat formues të moduleve. Këto pasqyrohen edhe në silabuse,</i>

	<i>ku pedagogu vendos metodat që do përdoren në seminarin e rradhës si psh: mësimi përmes projekteve, puna në grup, mësimi i ndërsjellë dhe diskutimet e strukturuar; rastet studimore.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Në bazë të kreut X-të Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, neni 103: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”, si dhe në bazë të VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, UET ka ndërtuar politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Në planin strategjik të UET, në përputhje me misionin dhe vizionin e zhvillimit të institucionit, një vëmendje e veçantë i kushtohet sigurimit të cilësisë si një kërkesë themelore për rritjen e reputacionit të UET brenda dhe jashtë vendit. Konkretisht, te prioritetet e planeve strategjike specifikohet se: “UET ushtron veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të Procesit të Bolonjës. Për sigurimin e cilësisë UET, aplikon Standardet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë, të orientuara në Strategjitë, politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë, aprovimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve të studimit, vlerësimi i studentëve, sigurimi i cilësisë së stafit akademik, burimet e të nxëniet dhe përkrahja e studentëve, sistemet informative, etj.”</p> <p>Në pikën 6.1. të nenit 6 të rregullores mësimore të UET përcaktohet se pjesë e strukturave të posatshme për sigurimin e standarteve dhe cilësisë janë Zyra e Standarteve dhe Cilësisë, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Burimeve Njerëzore si dhe Zyra e Kurrikulave. Gjithashtu bazuar në dokumentin Strategjia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për 5 vjeçarit 2023-2028, UET specifikon tërësinë e politikave, strukturave dhe procedurave për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p>nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale të cilësisë ,referuar <i>Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, (Ref. Nr.30.3.); Vendimi i Senatit Nr.15 prot, Datë 23.12.2022 Për miratimin e Strategjisë së Sigurimit të Cilësisë 2023-2028 (Ref.Nr.30.3.1)</i> të miratuar me vendim senati. Elementët proceduralë specifikohen konkretisht në Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, referuar Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, (Ref. Nr.30.2). Një tjetër dokument i rëndësishëm, në shërbim të mirëfunksionimit të sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Manuali paraqet: parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë; proceset dhe mekanizmat e monitorimit, vlerësimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies dhe mësimnxënies; vlerësimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e shërbimeve për studentët në UET. Një zë të vecantë për këtë çështje thelbësore të performancës dhe funksionalitetit të institucionit ka edhe neni 11 në Statutin e UET. Referuar Statuti i UET, Neni 1, faqe 5, (Ref. Nr.2.).</p> <p>Përgjegjësia institucionale e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë i takon Zyrës së Standarteve dhe Cilësisë (ZSC) referuar Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, (Ref. Nr.30.2), në bashkëpunim me Zyrën e Kurrikulave. Në nivel fakulteti dhe universiteti organizohen dhe funksionojnë Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me anëtarë të përzgjedhur nga asambleja e personelit akademik si dhe me përfaqësues nga asambleja e studentëve. Referuar Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, (Ref. Nr.30.2).</p> <p>Duke u bazuar në dokumentacionin e referuar më lart konstatohet se procedurat dhe politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen</p>	<p>Në UET është ngritur Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC) i cili funksionon mbi bazën e specifikimeve të përcaktuara sipas statutit të UET, referuar Statuti i UET, Neni 11, faqe 5, (Ref. Nr.2.); Rregullore e UET, Neni 6 pika 6.1.2, faqe 2, (Ref. Nr.5); <i>Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2017-2022, (Ref. Nr.30.3.);</i> Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë (Ref. Nr.30.2), rregullores së institucionit referuar Rregullore e UET, Neni 6, pika 6.1.2.b., faqe 2,</p>

<p>studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>(Ref. Nr.5), strategjisë referuar Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, (Ref. Nr.30.3), së mirëpërcaktuar për sigurimin e cilësisë dhe manualit të cilësisë referuar Manuali për sigurimin e brendshëm të cilësisë, <i>Sistemi për sigurimin e cilësisë (Quality Assurance System)</i>, (Ref. Nr.30.2). Studentët përfshihen në proces nëpërmjet të qënit pjesë e KSBC referuar Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, (Ref. Nr.30.3), <i>pjesëmarrjes në fokus grupe referuar Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, (Ref. Nr.30.3)</i>, pjesëmarrjes në vlerësimin online në platformën UET-LMS në çdo moment duke komunikuar me stafin e UET, si dhe duke iu ofruar mundësia e trajtimit të ankimeve të tyre. Përfshirja e studentëve realizohet gjithashtu nëpërmjet një formulari të posatshëm, i cili mundëson që studentët anketohen nëse pedagogu shpjegon mirë, a e bën lëndën interesante apo jo, si dhe nëse pedagogu nxit interesin dhe mendimin kritik apo jo. Në pikën 3.1. Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Strategjisë 2023-2028 tek çështja “Organe, autoritete dhe struktura në nivel institucional” pika 3 specifikohen përgjegjësitë dhe kompetencat e KSBC. Bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm janë përfshirë në përmirësimin e cilësisë. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm konsiderohet thelbësore në terma të garantimit të objektivitetit dhe paanshmërisë gjithashtu edhe për të sjellë pikëpamje dhe perspektiva të ndryshme nga ato ekzituese brenda institucionit duke mundësuar në këtë mënyrë përmirësimin e praktikave që implementohen.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë në UET është realizuar përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë (raportet e RVJ pranë KSBC).</p> <p>UET është hapur për herë të parë me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 636, date 20.09.2006. Gjatë vitit 2017 UET i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm nga ekspertët e ASCAL për akreditimin institucional dhe në përfundim ka marrë vlerësim pozitiv, të shoqëruar me disa rekomandime, nga Bordi i Akreditimit. Konkretisht me vendimin Nr.12 datë 07.04.2017, UET ka marrë akreditimin institucional me kohëzgjatje 5 vite akademike (VBA Nr. 12 datë</p>

	<p>07.04.2017 "Për akreditimin institucional të UET", (Ref. Nr.54.3).</p> <p>Dhe në vitin 2022, UET është akredituar nga Quality Assurance Agency for Higher Education (Agjensia Britanike) duke marrë vlerësimin maksimal në akreditimin institucional deri në dhjetor 2027.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UET përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, të cilët ndihmojnë në pasqyrimin e gjendjes aktuale, si dhe identifikimin e arritjeve dhe dobësive në programin e studimit. Këta tregues janë të përcaktuar në përputhje me aktet rregullatore të brendshme të institucionit, të cilat përfshijnë kriteret dhe standardet për cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p> <p>Treguesit cilësorë përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimin e performancës akademike të studentëve, siç është shkalla e kalueshmërisë, notat e mesatares, dhe përfundimi i suksesshëm i projekteve dhe praktikave profesionale.</li> <li>• Pjesëmarrjen e studentëve në kërkim shkencor, përfshirë botimet, pjesëmarrjen në konferenca dhe aktivitete kërkimore.</li> <li>• Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies përmes feedback-ut të studentëve dhe vlerësimeve të jashtme të mësimdhënësve dhe metodave të përdorura.</li> <li>• Përformanca e stafit akademik në lidhje me prodhimtarinë kërkimore, zhvillimin e metodologjive të reja mësimdhënëse dhe integrimin e inovacioneve në proceset mësimore.</li> </ul> <p>Bazuar në këta tregues, institucioni merr masa nxitëse për të promovuar arritjet më të mira dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e programit të studimit. Kjo përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përformimin e studimeve dhe kërkimeve shkencore: promovimi i studentëve dhe stafit që kanë arritur rezultate të shkelqyera në fushën akademike dhe kërkimore.</li> <li>• Nxitjen e pedagogëve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, bazuar në feedback-un dhe treguesit cilësorë të performancës.</li> </ul>




	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mbështetje dhe stimuj për kërkime inovative dhe zhvillimin e projekteve shkencore që kontribuojnë në avancimin e fushës përkatëse të studimit.</li> </ul> <p>Ky proces nxit një mjedis të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, duke siguruar që programet e studimit dhe aktivitetet kërkimore të jenë të orientuara drejt arritjes së standardeve të larta dhe të qëndrueshme.</p>								
<b>Konkluzione</b>	<i>UET si institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td>Nuk përmbushet</td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati sikurse dhe në nivel departamenti.
<b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet	Raportet e vlerësimit në UET përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të

<p>e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>cilësisë. Konkretisht referuar relacionit mbi kontrollin e ushtruar për zhvillimin e provimeve (<i>Format Raporti kontrolli për Provimet, (Ref. Nr.30.6)</i>). (qofshin këto përfundimtare apo të ndërmjetme) në seksionin e parë të raportit evidentohen gjetjet (problematikat) duke evidentuar lëndën përkatëse dhe pedagogun përkatës, ndërsa në seksionin e dytë të raportit evidentohet një analizë më e detajuar e problematikës. Ky komponent shërben për evidentimin e rezultateve të vlerësimit, ndërsa kur përshkruhet metodologjia e punës së KSBC, evidentohen rezultatet e pritshme pasi metodologjia e punës përcakton kriteret e vlerësimit. Analizat vjetore në nivel departamenti shërbejnë më pas për të sqaruar masat e marra si dhe mënyrën sesi janë adresuar mangësitë potenciale në kuadër të përmirësimit të cilësisë. Raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullore dhe standardet e cilësisë. KSBC dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të mangësive të konstatuara, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për të vlerësuar realizimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit të studimit. Pjesë e këtij vlerësimi janë cilësia e mësimdhënies, kurrikula, didaktika, provimet, detyrat e studentëve etj.</p> <p>Metodat e përdorura në UET për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit janë: analiza bazuar në tregues të matshëm të cilësisë si nota mesatare në hyrje, nota mesatare në dalje,<sup>1</sup> kalueshmëria sipas lëndëve/moduleve, vlerësime të punës së pedagogëve gjatë semestrit nga kryerja e orëve monitoruese në leksione, rishikime vjetore të syllabuseve të lëndëve, përfshirja e eksperiencave më të mira ndërkombëtare, rezultat i angazhimit të stafit akademik në projekte, (analiza e infrastrukturës në dispozicion të procesit mësimor. Sikurse është përmendur dhe në kriteret e mësipërme, veprimtaria monitoruese e KSBC përfshin aktivitete monitoruese për:</p> <p>A. Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi (realizimi i procesit mësimor dhe marrja e mendimit të studentëve, përdorimi i sistemit të menaxhimit mësimor LMS, monitorime nga KSBC)</p>

	<p>B. Kërkimi shkencor (Vlerësim i realizimit të punëve kërkimore-shkencore në nivel Departamenti)</p> <p>C. Mbështetja e studentëve (monitorimi i hyrjeve/daljeve të studentëve, punësimi i të diplomuarve, lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione dhe subjekte).</p> <p>D. Sigurimi i Cilësisë (rishikimi i rregulloreve të UET dhe programit të studimit, zhvillimi i analizës SWOT, vlerësimi i burimeve njerëzore dhe mjedisit, notat, zhvillimi i testeve të ndërmjetme, përgatitja e syllabuseve, hartimi dhe shpallja e detyrave, trajnimi për standartet e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Pjesë e këtyre metodave janë pyetësorët online në UET LMS, fokus grupet, mbledhjet e bordit të punës me të diplomuar (alumni) të cilët synojnë përfshirjen e ish-studentëve në aktivitete dhe shkëmbimin e eksperiencave në UET.</p> <p>Gjithashtu, aktivitete të tjera të rëndësishme, të cilat shërbejnë për të vlerësuar dijet e kompetencave që transmeton ky program studimi, janë Panairi i Përvitshëm i Punës, mbledhjet e personelit akademik, ndihmës akademik, vizita monitoruese nga drejtuesi i departamentit, Dekani, Përgjegjësi i grupit mësimor.</p> <p><i>(Strategjia për sigurimin e brendshëm të cilësisë 2023-2028, Kreu IV Fusha dhe qasje të vlerësimin në kuadër të sigurimit të cilësisë, pika 4.1. Cilësia e Programeve të Studimit dhe Mësimdhënia (Ref. Nr.30.3); Poster Panairi i Punës 2023-2024, (Ref. Nr.12.3); Poster Panairi i Punës 2022-2023, (Ref. Nr.12.3.1).</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel Rektorati sikurse dhe në nivel departamenti. Institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta për vlerësimin e mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit.</i></p>

	<i>Pjesë e këtyre metodave janë pyetësorët online në UET LMS, fokus grupet, mbledhjet e bordit të punës me të diplomuar (alumni) të cilët synojnë përfshirjen e ish-studentëve në aktivitete dhe shkëmbimin e eksperiencave në UET.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi VI.4**  
**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Strukturat përgjegjëse të sigurimit të brendshëm të cilësisë të përbërë nga përfaqësues të strukturave hierarkike të institucionit dhe Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë parashikojnë politika dhe procedura të brendshme për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë zhvillohet në përputhje me kuadrin rregullator të UET, objektivat strategjike, vizionin dhe misionin e institucionit. Parimet, detyrat dhe aktivitetet e sigurimit të cilësisë së brendshme janë të mbështetura në Statutin e institucionit, Rregulloren, Strategjinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, udhëzimet e standardeve europiane dhe standardet kombëtare për sigurimin e cilësisë. Në këtë kuadër rregullator dhe udhëzues përcaktohen qartë organizimi, funksionet, përgjegjësitë dhe detyrat e zyrave përbërëse si dhe dokumentacioni i nevojshëm për procesin e vlerësimit të brendshëm.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>UET përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Institucioni ka përmirësuar praktikën dhe metodologjinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në sajë të pjesëmarrjes në trajnime, vizita studimore, ëorkshope të organizuara në kuadër të projekteve ndërkombëtare për të garantuar ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p> <p>Strategjia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përshkruan organizimin dhe funksionimin e sistemit për sigurimin e brendshëm të cilësisë në lidhje me parimet, qëllimin,</p>

	objektivat, strukturat përbërëse, përgjegjësitë, detyrat, trajnimet, angazhimin e studentëve dhe palëve të tjera.
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>Departamenti dhe personeli akademik i programit të studimit Bachelor në Psikologji përditësohet me informacion dhe kontribuon në mënyrë të vazhdueshme me analiza dhe sugjerime në procesin e vlerësimin të brendshëm. Disa elemente të rëndësishme që tregojnë përfshirjen në këtë proces të njësisë bazë dhe kryesore për programin e studimit realizohet nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vlerësimin të përmbajtjes akademike:</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit ka detyrën e kryesore për zhvillimin dhe rishikimin e kurrikulave, metodologjive të mësimdhënies dhe vlerësimin, duke siguruar që ato të jenë të përshtatshme për nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës.</li> <li>• <b>Përmirësimi i vazhdueshëm i programit:</b> Njësia duhet të angazhohet për një proces të vazhdueshëm reflektimi dhe përmirësimi, duke bazuar vlerësimin në të dhëna të grumbulluara nga studentët, personeli akademik dhe të tjerët.</li> </ul> <p><b>2. Përfshirja e personelit akademik:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies:</b> Personeli akademik duhet të jetë pjesë e vlerësimin të vazhdueshëm të mësimdhënies, duke marrë pjesë në grupe pune dhe aktivitete të vlerësimin të mësimdhënies dhe didaktikës. Ata gjithashtu duhet të sigurojnë se metodat dhe materialet mësimore janë të azhurnuara dhe efektive.</li> </ul> <p><b>3. Përfshirja e personelit ndihmësakademik dhe administrativ:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mbështetje në organizimin dhe administrimin e programit të studimit:</b> Personeli ndihmësakademik dhe administrativ luan një rol kyç në sigurinë e funksionimit të përditshëm të</li> </ul>




	<p>programit të studimit, duke siguruar që të gjitha proceset administrative, si regjistrimi i studentëve, vlerësimi i lëndëve dhe mbështetje logjistike, të realizohen në përputhje me politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Koordinimi me njësitë akademike dhe mbështetje për studentët:</b> Administrata gjithashtu duhet të bashkëpunojë me njësitë akademike për të siguruar që të dhënat dhe informacionet të menaxhohen në mënyrë të efektshme, për të mbështetur studentët dhe për të garantuar një proces mësimor të suksesshëm.</li> </ul> <p><b>4. Përfshirja e studentëve:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Feedback nga studentët:</b> Studentët janë aktorë kyç në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Ata duhet të kenë mundësinë të japin mendimet e tyre për përbajtjen akademike, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimin, përmes sondazheve, grupeve fokusimi dhe takimeve me përfaqësues të njësive akademike.</li> <li>• <b>Angazhimi në procesin e vlerësimit të cilësisë:</b> Studentët duhet të inkurajohen të angazhohen në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë, si pjesëmarrës në aktivitete që kanë të bëjnë me vlerësimin e mësimdhënies dhe të përfshihen në mbledhjet e përbashkëta për rishikimin e kurrikulave dhe metodologjive.</li> </ul> <p><b>5. Angazhimi i partnerëve të jashtëm dhe aktorëve të tjerë:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Bashkëpunimi me punëdhënësit dhe institucione të tjera:</b> Institucionet duhet të angazhojnë punëdhënësit dhe partnerët të jashtëm për të siguruar që programet e studimit janë të lidhura ngushtë me kërkesat e tregut të punës dhe që studentët janë të përgatitur për karrierën e tyre. Ky angazhim mund të realizohet përmes praktikave profesionale, mundësive për punësim, dhe trajnimeve.</li> </ul>
--	---




<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Ky kriter përmbushet duke qënë se në përzgjedhjen e anëtarëve të KSBC, që kryen proceset ciklike të vlerësimit, meren parasysh kriteret e mëposhtme: Kompetencat profesionale; Paanshmëria; Mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin; Shkalla e nevojshme e njohjes të anëtarëve të Komisionit; Të mos jenë pjesë e autoriteteve drejtuese të UET; Etj.</p> <p><b><i>Dokumenti F. VII. Mbi sigurimin e brendshëm të cilësisë, Pika F.VII.7 (Ref. Nr. 8)</i></b></p>		
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Ky kriter përmbushet nëpërmjet angazhimit të ekspertit të jashtëm në strukturën e KSBC-së, nëpërmjet takimeve me Bordin e Tregut të Punës, Edhe pjesëmarrjet që UET ka patur në projektet e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë, janë tregues i angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p>		
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>UET si institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Departamenti dhe personeli akademik i programit të studimit Bachelor në "Psikologji", me profil "Shëndet Mendor" përditësohet me informacion dhe kontribuon në mënyrë të vazhdueshme me analiza dhe sugjerime në procesin e vlerësimit të brendshëm.</i></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.5</b> <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për</p>	<p>Politikat, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Kuadri rregullator i UET</p>

<p>programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>parashikon publikimin e veprimtarive përfshirë dhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, në faqen zyrtare të UET. Publikimet në faqen zyrtare të UET respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Informacioni në nivel program studimi dhe departamenti përcillet te struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën UET LMS.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Duke marrë në konsideratë faktin se raportet e KSBC-së përmbajnë të dhëna sensitive dhe personale, ato bëhen pjesë e diskutimeve në ato grupe për të cilat Raporti ka ndikim të drejtpërdrejtë. Raporti në tërësi i shpërndahej drejtueseve, ndërsa në departamente diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë departament. Në ato raste kur të dhënat vlerësohen se kanë një sensibilitet të lartë, rastet trajtohen nga strukturat drejtuese me personin konkret në takime individuale. UET publikon në faqen zyrtare rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit (RVB), duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionit të mësuar apo vënë në dispozicion, të konsideruar konfidencial.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të KSBC shoqërohen me plan masash, që adresojnë dhe synojnë plotësimin e mangësive dhe reduktimin apo eliminimin e dobësive të evidentuara, për përmirësimin e cilësisë duke filluar që nga njësia bazë. Në mënyrë periodike, çdo javë zhvillohen mbledhjet e departamentit me personelin akademik ku diskutohet dhe analizohet në mënyrë të detajuar ecuria dhe problematikat e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe sugjerohen masa për ndërhyrje në përputhje me gjetjet dhe nevojat. Më pas diskutohet në nivel njësie bazë dhe kryesore dhe bazuar në propozimet e bëra prej tyre, hartohet plani i masave në nivel universiteti. Ky plan masash miratohet nga Senati Akademik dhe zbatohet në vitin pasues.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë nëpërmjet “kontrollit të kryqëzuar” (cross-check) që implementohet nga struktura dhe aktorë të brendshëm në UET, duke filluar nga njësiti bazë nëpërmjet drejtuesit të departamentit, përgjegjësit të gruplëndëve e koordinatorit të programit, te strukturat e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional,</p>

	Zyra e Kurrikulave ,Zyra e Standardeve dhe Cilësisë e Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë .			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>UET organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit Bachelor në Psikologji.</p> <p>Këto veprimtari përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime periodike me studentët dhe përfaqësuesit e tyre për të mbledhur opinionet dhe sugjerimet mbi përmbajtjen e programit, metodat e mësimdhënies dhe praktikat e vlerësimit. Këto takime organizohen të paktën një herë në semestër dhe shërbejnë si platforma për bashkëpunim konstruktiv.</li> <li>• Ëorkshop-e dhe trajnime për stafin akademik dhe administrativ, që trajtojnë tema të tilla si: standardet e akreditimit, praktikat e sigurimit të cilësisë, vetëvlerësimi dhe zhvillimi profesional në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</li> <li>• Pyetësorë të strukturuar për studentët, të cilët administrohen në fund të çdo semestri për të vlerësuar përmbushjen e objektivave të programit, cilësinë e mësimdhënies, si dhe mjedisin akademik në tërësi.etj.</li> </ul> <p>Këto iniciativa kontribuojnë në krijimin e një kulture të brendshme cilësie, ku çdo anëtar i komunitetit universitar ndihet pjesë aktive në përmirësimin afatgjatë të programit të studimit.</p>			
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Kuadri rregullator i UET parashikon publikimin e veprimtarive përfshirë dhe ato për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në nivel universiteti, në faqen zyrtare të UET. Publikimet në faqen zyrtare të UET respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale. Informacioni në nivel program studimi dhe departamenti përcillet te struktura përkatëse nëpërmjet shkresave zyrtare në pajtim me kuadrin rregullator të institucionit, ndërsa studentët informohen përmes komunikimeve në platformën UET LMS.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet Pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Psikologji” me profil në “Shëndet Mendor” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Europian i Tiranës”.**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Përputhje e plotë me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare. Programi është i ndërtuar sipas VKM nr. 41 dhe vendimeve përkatëse mbi strukturën e studimeve (ECTS, komponentë të qartë lëndorë, praktika profesionale etj.)

2. Kurrikul e përditësuar dhe e strukturuar mirë. Përmbajtja teorike e kombinuar me komponentë praktikë; Përqindjet e komponentëve mësimorë janë në përputhje me udhëzimet ligjore.

3. Staf akademik i kualifikuar. Përfshirja e stafit me tituj shkencorë (Prof. Dr., Prof. Asoc. Dr., PhD, MSc); Shkalla e mbulimit nga PAE është mbi minimumin ligjor, me një raport PAE/PAK që e tejkalon standardin në disa raste (p.sh. 31/0).

4. Praktika profesionale reale në institucione të fushës. Zhvendosja e praktikave nga auditoret drejt institucioneve konkrete të shërbimeve psikologjike; Marrëveshje bashkëpunimi me institucione të tilla si Urdhri i Psikologut, Mental Health Albania, Aksion Plus etj.

5. Infrastrukturë e përshtatshme dhe burime bashkëkohore. Bibliotekë fizike dhe dixhitale e pasur (abonim në Elgar Online); Rregullore që kërkon përdorim literature brenda 5 viteve të fundit nga botime prestigjioze si Oxford, Cambridge, Sage etj.

6. Përputhje me misionin e universitetit dhe strategjinë kombëtare. Programi është në linjë me misionin për formim të cilësisë së lartë akademike dhe përgatitje profesionale; Kontribuon në objektivat e Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe Strategjisë së Kërkimit të vetë institucionit.

7. Angazhim në ndërkombëtarizim dhe zhvillim të mëtejshëm. Bashkëpunim me Erasmus+.

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

## **Pika të dobta:**

1. Mungesa e lëndës së Etikës profesionale, ku në planin aktual mungon lënda “Etikë në ushtrimin e profesionit të psikologut”, që është jetike për praktikën profesionale dhe përgatitjen për licencim profesional. Një element ky që do t’I vinte në ndihmë realizimit të praktikës profesionale për studentët. (Standarti II.1, kriteri 4)

## **Rekomandime:**

*Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, programit, syllabuseve dhe nëpërmjet vizitës monitoruese në Institucionin faktim se është ndryshuar modaliteti i programit të praktikës nga praktikë me të ftuar në auditore në praktikë me atashim pranë Istitucioneve ku ushtrohet roli i psikologut do të duhet që të parashikohet përfshirja e lëndës së Etikës si lëndë më vete dhe jo si pjesë e integruar brenda një lënde tjetër. Pavarësisht se në nivel Bachelor, studentët nuk ushtrojnë rolin e psikologut dhe nuk punojnë direkt me klientë edhe në rolin e vëzhguesit në ambiente profesionale, ata janë të ekspozuar ndaj situatave reale dhe të ndjeshme, ndaj lënda e Etikës mbetet thelbësore si modul i pavarur. Në këtë kontekst do të vlerësoja të merreshin në konsideratë argumentat e mëposhtëm si rekomandime:*

1. Përgatitja për master dhe licencim nis në Bachelor. Etika nuk është vetëm për ata që ushtrojnë profesionin, por është komponent formues në përgatitjen për ciklin pasues; Duke marrë etikën që në Bachelor, studentët janë të gatshëm të hyjnë në praktikën e mbikëqyrur të Masterit me një kuptim të qartë të kufijve, detyrimeve dhe vlerave profesionale. Edhe si vëzhgues, studentët janë pjesë e kontekstit profesional. Edhe pse nuk ndërhyjnë, studentët ekspozojnë veten në institucione ku zhvillohen marrëdhënie profesionale konfidenciale; ata mund të kenë akses në informacion të ndjeshëm, raporte klinike, biseda me klientë, ose të jenë të pranishëm në situata të dilemave etike.
2. Përputhje me praktikën e edukimit në programet cilësore jashtë vendit. Rekomandohet të vijohet puna me anëtarësimin në burimet elektronike në shërbim të programit të studimit dhe gjithashtu të shtohet literatura në gjuhën shqipe në bibliotekën fizike. Në shqyrtimin e programit të studimit mungon një analizë statistikore mbi përdorimin aktual të burimeve bibliotekare nga studentët e programit, si numri i huazimeve, përdorimi i databazave, qasja në literaturë digjitale etj.
3. Rekomandohet që institucioni të ndërmarrë hapa konkretë drejt përmbushjes së kriteve të anëtarësimin në organet ndërkombëtare të akreditimit të programeve dhe certifikimit të psikologëve. Anëtarësimi në këto platforma do të rrisë më tej ndërkombëtarizimin, njohjen ndërkombëtare të diplomës dhe mobilitetin profesional të studentëve dhe stafit akademik. (Fusha III/ Standarti III.4/ kriteri 2)

4. Pavarësisht pasurimit me literaturë të huaj, sugjerohet shtimi i burimeve në gjuhën shqipe, veçanërisht për një program me fokus në shëndetin mendor dhe përgatitjen profesionale në kontekstin shqiptar. (Standardi IV.3/ Kriteri 1.)

**Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor in "Psychology" in "Mental Health" provided by the Higher Education Institution "European University of Tirana".**

**Strengths and affirmations:**

1. Full compliance with the legal framework and national standards. The program is built according to VKM no. 41 and the relevant decisions on the structure of studies (ECTS, clear subject components, professional practice, etc.)
2. Updated and well-structured curriculum. Theoretical content combined with practical components; The percentages of teaching components are in line with legal guidelines.
3. Qualified academic staff. Inclusion of staff with scientific titles (Prof. Dr., Prof. Assoc. Dr., PhD, MSc); The coverage rate by PAE is above the legal minimum, with a PAE/PAK ratio that exceeds the standard in some cases (e.g. 31/0).
4. Real professional practice in institutions in the field. Relocation of practices from auditors to concrete institutions of psychological services; Cooperation agreements with institutions such as the Order of Psychologists, Mental Health Albania, Aksion Plus, etc.
5. Appropriate infrastructure and modern resources. Rich physical and digital library (subscription to Elgar Online); Regulation requiring the use of literature within the last 5 years from prestigious publications such as Oxford, Cambridge, Sage, etc.
6. Compliance with the university's mission and national strategy. The program is in line with the mission of high-quality academic formation and professional preparation; Contributes to the objectives of the National Strategy for Education and the Research Strategy of the institution itself.
7. Commitment to internationalization and further development. Cooperation with Erasmus+.




**Weaknesses:**

1. Lack of the subject of Professional Ethics, where the current plan lacks the subject "Ethics in the exercise of the profession of psychologist", which is vital for professional practice and preparation for professional licensing. This is an element that would help the realization of professional practice for students. (Standard II.1, criterion 4)

**Recommendations:**

*Referring to the review of the documentation, program, syllabus and through the monitoring visit to the Institution, the fact that the modality of the internship program has been changed from internship with guests in the auditorium to internship with attachment at the Institutions where the role of psychologist is exercised will have to be foreseen to include the Ethics subject as a separate subject and not as an integrated part within another subject. Despite the fact that at the Bachelor level, students do not exercise the role of psychologist and do not work directly with clients even in the role of observer in professional environments, they are exposed to real and sensitive situations, so the Ethics subject remains essential as an independent module. In this context, I would appreciate the following arguments being taken into consideration as recommendations:*

1. Preparation for the Master's and licensure begins in the Bachelor's. Ethics is not only for those who practice the profession, but is a formative component in preparation for the subsequent cycle; By taking ethics in the Bachelor's, students are ready to enter the supervised practice of the Master with a clear understanding of professional boundaries, obligations and values. Even as observers, students are part of the professional context. Although they do not intervene, students expose themselves to institutions where confidential professional relationships develop; they may have access to sensitive information, clinical reports, conversations with clients, or be present in situations of ethical dilemmas.
2. Compliance with educational practices in quality programs abroad. It is recommended to continue work on membership in electronic resources in the service of the study program and also to add literature in the Albanian language to the physical library. In the review of the study program, a statistical analysis on the current use of library resources by students of the program, such as the number of loans, use of databases, access to digital literature, etc., is missing.
3. It is recommended that the institution take concrete steps towards meeting the criteria for membership in international bodies for accreditation of programs and certification of psychologists. Membership in these platforms will further increase



internationalization, international recognition of the diploma and professional mobility of students and academic staff. (Area III/ Standard III.4/ Criterion 2)

4. Despite the enrichment with foreign literature, it is suggested to increase resources in Albanian, especially for a program with a focus on mental health and professional preparation in the Albanian context. (Standard IV.3/ Criterion 1.)

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

